



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

DISERTACION

Paraqitur nga:

M.Sc.Ing. Alfred HASANAJ

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE

DOKTOR

NË FUSHËN E INXHINIERISË MEKANIKE

**TEMA: " Vlerësimi i Integritetit të Tubacioneve të Gazit-Rast Studimi Gazsjellësi
TAP-Shqipëri "**

Udhëheqësi Shkencor

Akademik Jorgaq KAÇANI

Tiranë, 2019



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

DISERTACION

Paraqitur nga:

M.Sc.Ing.Alfred HASANAJ

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE

DOKTOR

NË FUSHËN E INXHINIERISË MEKANIKE

**TEMA: " Vlerësimi i Integritetit të Tubacioneve të Gazit-Rast Studimi Gazsjellësi
TAP-Shqipëri "**

Mbrohet me datë ____/____/ 2019, para Komisionit të përberë nga :

- | | |
|---------------|-----------------|
| 1. Prof._____ | Kryetar |
| 2. Prof._____ | Anëtar, Oponent |
| 3. Prof._____ | Anëtar |
| 4. Prof._____ | Anëtar |
| 5. Prof._____ | Anëtar, Oponent |

ABSTRAKT

Gazsjellësi TAP është ndër projektet më të rëndësishme për Europen dhe për vete Shqipërinë. Në këtë punim do të analizohen fazat e ndërtimit të gazsjellësit dhe ndikimi që ka secila në integritetin e linjës së gazsjellësit. Në çdo fazë të ndërtimit të gazsjellësit kemi ndikuar në rritjen e cilësisë dhe mbrojtjen e integritetit të linjës. Pas analizave dhe vlersimeve të ndryshme që kemi bërë, elementët që ndikojnë më shumë në integritetin e linjës së gazsjellësit janë : procesi i saldimit, mbrojtja pasive dhe testimi hidrostatikë.

Për realizimin e procesit të saldimit zgjodhëm metodën me gaz mbrojtës 135 (MAG) automatik që bën pjesë në grupin e saldimeve me shkrirje të materialit bazë ashtu dhe materialit mbushës. Ku përdoret edhe një mbështetje provizore Cu (bakri) për rrënjën e saldimit , ku shpejtësia që ofron ky proces ul energjinë ndërsa gazi mbrojtës rrit temperaturën në banjë dhe shton penetrimin. Kemi ndikuar në rritjen e cilësisë së procesit të saldimit në çdo fazë të realizimit të tij, përveç kësaj kemi analizuar nëse karakteristikat mekanike të materialit të tegelit të saldimit afroheshin me atë të materialit bazë , duke marrë si rast studimi një kampion në linjën e gazsjellësit , në të cilin realizuam provat laboratorike , konkretisht provën në tërheqje, në përkulje, të impaktit dhe provën e fortësisë.

Mbrojtja pasive është një ndër elementet e rëndësishme që ndikojnë në integritetin e linjës së gazsjellësit. Për të analizuar këtë, kemi marrë disa raste studimi nga linja e gazsjellësit dhe është arritur në konkluzionin që nyja e veshur me material mbrojtës, që të garantojë integritetin e saj duhet ti nënshtrohet testeve, të matjes së spesorit të veshjes, testimit të fortësisë, testit për mbushje të plotë të nyjes dhe testit të adezionit.

Testimi hidrostatik është një ndër proceset që vlerëson dhe provon integritetin e linjës së gazsjellësit TAP.

Me anë të këtij procesi në realizojmë pastrimin e tubacionit, vlerësojmë deformimet që ai mund të ketë , me anë të testimit provojmë integritetin e tubacionit të gazit , me anë të tharjes eliminojmë korrozionin e brendshëm dhe me anë të Caliper Pig vlerësojmë nëse tubacioni ka ovalitete , dente, gunga dhe humbjet e spesorit në linje.

Ky proces realizohet në disa faza dhe për çdo fazë në kemi ndikuar në rritjen e cilësisë dhe mbrojtjen e integritetit të linjës. Për të vlerësuar këtë, kemi marrë disa raste studimi dhe konkretisht për të vlerësuar se si ndikon procesi i pastrimit, i vlersimit të gjeometrise dhe procesi i tharjes në integritetin e linjës së gazsjellësit kemi marrë në studim seksionin nr.1 të gazsjellësit TAP, ndërsa për të vlerësuar dhe provuar integritetin e linjës së gazsjellësit TAP Shqipëri kemi marrë në studim seksionin e valvulave ABV-25 dhe seksionin nr.2 të linjës së gazsjellësit.

Fjalë Kyçe: Gazsjellësi TAP, vlersimi i integritetit, procesi i saldimit , mbrojtja pasive , testimi hidrostatik.

ABSTRACT

Trans Adriatic pipeline is one of the most important projects for Europe and Albania itself. In this research we will analyze the phases for construction of gas pipeline, and their impact on the gas pipeline integrity. In each of the phases of construction you will notice how we have contributed in the improvement of the quality, leading to the safety and integrity of the gas pipeline. Based on the analyses conducted, phases which mainly contribute to the gas pipeline integrity are: the process of welding, passive protection and hydrostatic testing. In order to conduct the process of welding we have chosen to use Metal Active Gas (MAG) method 135 fully mechanized. This method of welding belongs to the group of fusion welding by melting both base material and the filler material. In this process we use also temporary copper shoes backings (Cu) positioned in the welding root. The speed that this process offers functions by decreasing the heat input and the active shielding gas (CO₂) increases the temperature in the welding pool leading to improved penetration. In this presentation you will see the impact we have made on improving the quality and integrity of gas pipeline in each phase of the project. Besides this we have analyzed the mechanical characteristic similarity of the welding seam material and the base material. To achieve this result, we have taken a test coupon from the gas pipeline and conducted tests in laboratory in more particular the tensile test, bending test, impact test and hardness test.

Passive protection is one of the crucial elements which have great impact on the integrity of gas pipeline. In order to analyze this element we have conducted several case studies taken from gas pipeline reaching to a conclusion that, to secure the integrity the joint coated with protective material must be tested, by measuring coating thickness (DFT), hardness test, Holiday Test, and adhesion test.

Next in line will be the hydrostatic test which evaluates and proves the integrity of gas pipeline for TAP. Through this process we realize the pipeline cleaning, we evaluate whether there is any deformation of the pipe. Through the hydrostatic testing we confirm the pipeline integrity, and through the drying process we prevent the internal corrosion and lastly through the Caliper Pig we assess if the pipeline has ovalities, dents and wall thickness measurement.

Hydrostatic testing is conducted in several phases, where for each and every phase we have contributed the protection and improvement of the gas pipeline integrity. To evaluate this, we have taken several case studies to understand how the cleaning process, geometrical assessment and the drying process affect the pipeline integrity. To do this we have studied the section No.1 of TAP. In addition, to evaluate and prove the integrity of gas pipeline for the Albanian territory we have conducted a case study in the Block Valve Station ABV-25 and the section No.2 of the gas pipeline.

Key words: Trans Adriatic Pipeline, Integrity evaluation, welding process, passive protection, hydrostatic testing.

PËRMBAJTJA

LISTA E FIGURAVE

LISTA E TABELAVE

LISTA E GRAFIKËVE

ANEKSET

KREU I

VËSHTRIME TË PERGJITHSHME MBI GAZSJELLSIN TRANS ADRIATIK PIPELINE

1.1 Hyrje.....	11
----------------	----

KREU II

PROÇESET E NDËRTIMIT TË GAZSJËLLSIT TAP- SHQIPËRI

2.1 Fazat e ndërtimi të Gazsjellësit TAP.....	13
2.2 Procesi i pastrimit dhe sistemimit të gjurmës.....	13
2.3 Procesi shtrimit dhe harkimit të tubave.....	14
2.4 Procesi i saldimit dhe testimit të tubave me rreze ultratinguj.....	15
2.5 Procesi i lyerjes se nyjave të salduara me material mbrojtës.....	24
2.6 Procesi i hapjes së kanalit të tubit	28
2.7 Procesi i uljes së tubit në tokë	29
2.8 Procesi i mbulimi të tubit dhe kthimi i tokës në gjendje fillestare.....	30

KREU III

ANALIZA E PROCESEVE QË NDIKOJNË NË INTEGRITETIN E TUBACIONEVE TË GAZIT-RASTE
STUDIMI GAZSJELLSI TAP- SHQIPËRI

3.1 Procesi i saldimit, raste studimi.....	32
3.2 Mbrojtja pasive, raste studimi.....	37
3.3 Testimi Hidrostatik.....	43

KREU IV

RAST STUDIMI -APLIKIMI I PROCESIT TË PASTRIMIT, VLERSIMIT TË GJEOMETRISE DHE THARJES NË SEKSIONIN NR.1 TË GAZSJELLSIT TAP-SHQIPËRI.

4.1Vlerësimi i pastërtisë së seksionit KP209 deri në KP197.....	59
4.2Vlerësimi i gjeometrisë së seksionit të marr në studim.....	64
4.3Vlerësimi i tharjes së tubacionit	67

KREU V

TESTIMI HIDROSTATIK,VLERSIMI I INTEGRITETIT TE STACIONIT TE VALVULAVE –
RAST STUDIMI ABV25 GAZSJELLSIT TAP-SHQIPËRI.....74

KREU VI

TESTIMI HIDROSTATIK ,VLERSIMI I INTEGRITETIT TE LINJAVE KRYESORE RAST STUDIMI-
SEKSIONI NR.2 I GAZSJELLSIT TAP-SHQIPËRI.....103

KONKLuzionET.....115

REFERENCAT.....149

LISTA E FIGURAVE

Figura 1.1 Vendburimi i Gazsjellësit TAP.....	11
Figura 1.2 Aksionerët e Gazsjellësit TAP.....	11
Figura1.3 Gjurma e Gazsjellësit TAP Shqipëri.....	12
Figura 2.1 Pastrimi dhe sistemi gjurmës.....	14
Figura 2.2 Shtrimi i tubave.....	14
Figura 2.3 Harkimi i tubave.....	15
Figura 2.4 Faza pas përfundimit të hapjes së tubove.....	16
Figura 2.5 Faza pas përfundimit të saldimit.....	16
Figura 2.6 Gjatë saldimit të tubacionit TAP.....	16
Figura 2.7 Zmusimi.....	17
Figura 2.8 Pajisja tornuese e përgatitjes së zmusos së saldimit.....	17

Figura 2.9 Zmusimi.....	17
Figura 2.10 Demagnetizimi.....	18
Figura 2.11 Pastrimi.....	18
Figura 2.12 Para ngrohja me anë të induksionit.....	20
Figura 2.13 Montimi.....	21
Figura 2.14 Gjatë procesit të saldimit automatik.....	21
Figura 2.15 Tegeli i saldimit gjatë kontrollit dimensional dhe pas inspektimit vizual.....	22
Figura 2.16 Vendosja e mbështjelljes termoizoluese.....	23
Figura 2.17 Teknika PA dhe TOFD për inspektimin e rrënjës.....	24
Figura 2.18 Veshja e tubit në projektin TAP.....	24
Figura 2.19 Inspektimi Fillestar.....	25
Figura 2.20 Parangrohja.....	26
Figura 2.21 Përgatitja e sipërfaqes së metalit.....	27
Figura 2.22 Profili i sipërfaqes.....	27
Figura 2.23 Aplikimi i veshjes.....	28
Figura 2.24 Hapja e kanalit.....	29
Figura 2.25 Ulja e Tubit.....	30
Figura 1.26 Mbulimi i tubit dhe kthimi i tokës në gjendjen fillestare.....	31
Figura3.1 Defektet ne strukturën e materialit.....	32
Figura 3.2 Kampioni objekt studimi, i marre ne KP04 W34 te linjes se gazsjellësit.....	33
Figura 3.3 Kampioni pas provës së terheqjes.....	33
Figura 3.4 Kampioni i provës në përkulje	34
Figura 3.5 Kampionet pas provës se goditjes.....	35
Figura 3.6 Kampioni i provës në goditje.....	36
Figura 3.7 Testi i fortësisë se sipërfaqes.....	36
Figura 3.8 Matja e spesorit te nyjës të veshur në KP139-W10.....	38
Figura 3.9 Matja e fortësisë se nyjes të veshur në KP120-W21.....	38
Figura 3.10 Kontrolli i nyjës së veshur me HD test.....	39
Figura 3.11 Testi i adezionit në nyjën KP139-W10.....	39
Figura 3.11.1 Instrument matës DCVG.....	40
Figura 3.12 Operatori i DCVG gjatë një analize DCVG në pikën kilometrike 22 të tubacionit TAP.....	41
Figura 3.13 Zbulimi i një defekti me tekniken DCVG.....	42

Figura 3.14 Futja e pigut në kokën testuese.....	44
Figura 3.15 Dalja e pigut.....	44
Figura 3.16 Dalja e Pigut magnet.....	45
Figura 3.17 Nisja e Pigut.....	45
Figura 3.18 Sasia e mbetjeve që dalin përpara pigut.....	46
Figura 3.19 Pllaka e Aluminit.....	47
Figura 3.20 Gjatë instalimit dhe futjes së pigut me pllakën e aluminit në tubacion.....	47
Figura 3.21 Caliper Pig.....	58
Figura 3.22 Deformimet e tubit të konstatuara nga caliper pig.....	59
Figura 4.1 Vendi ku do të niset pigu i pastrimit.....	60
Figura 4.2 Instalimi i kompresorëve.....	60
Figura 4.3 Instalimi i valvulës së sigurisë.....	60
Figura 4.4 Skema e nisjes së pigut në seksion dhe mbërritja e tij.....	61
Figura 4.5 Futja e pigut në celaning Header.....	61
Figura 4.6 Injektimi i ajrit në seksion para pigut.....	61
Figura 4.7 Injektimi i ajrit pas pigut.....	61
Figura 4.8 Nxjerrja e ajrit nga seksioni.....	63
Figura 4.9 Nisja e pigut të parë.....	63
Figura 4.10 Mbërritja e pigut.....	63
Figura 4.11 Nisja e pigut të dytë.....	64
Figura 4.12 Mbërritja e pigut të dytë.....	64
Figura 4.13 Nisja e pigut të tretë.....	64
Figura 4.14 Mbërritja e pigut të tretë.....	64
Figura 4.15 Matja e diametrit dhe e spesorit të pllakës së aluminit.....	66
Figura 4.16 Firmosja e pllakës së aluminit.....	66
Figura 4.17 Futja e Pigut me pllakën e aluminit në sekion.....	66
Figura 4.18 Nuk vërehen deformime në pllakën e aluminit, pllaka firmoset dhe pranohet.....	67
Figura 4.19 Pigu i parë i sapo dal nga tubacioni ,më shume se $3/4$ e diametrit është e njomë.....	68
Figura 4.20 Pigu i dytë i sapo dal nga tubacioni ,më shumë se $1/4$ e diametrit është e njomë.....	68
Figura 4.21 Pigu i trete i sapo dal nga tubacioni.....	69
Figura 4.22 Pigu i katër i sapo dal nga tubacioni	69
Figura 4.23 Pigu i peste i sapo dal nga tubacioni.....	69

Figura 4.24 Pigu i gjashte i sapo dal nga tubacioni.....	69
Figura 4.25 Pigu i 7 i sapo dal nga tubacioni,.....	70
Figura 4.26 Shtate foam pig u futën në seksion për të arritur kushtet e pranueshmerisë.....	70
Figura 4.27 Dew point -0.15°C i seksionit.....	70
Figura 4.28 Dew Pointi i temperaturës së ambientit 10.22 °C.....	70
Figura 4.29 Testimi i dy pajisjeve të tharjes së tubit.....	71
Figura 4.30 Foto gjatë testimit të paisjes.....	71
Figura 4.31 Gjatë testimit të pajisjes ne matem vlerën e dew pointit në linjën që montuam dhe arritëm në konkluzionin që dew pointi që arrinte në linje ishte -50 °C.....	72
Figura 4.32 Dew Pointi që arriti pajisja gjatë testimit.....	72
Figura 4.33 Injektimi i ajrit të thatë në seksion.....	72
Figura 4.34 Dew pointi në seksion -20 °C, Brenda kushteve të pranueshmërisë.....	73
Figura 4.35 Saldimi i pllakës metalike, instalimi i valvulave dhe injektimi në seksion 0.13 bar.....	73
Figura 5.1 Pamje e përgjithshme e stacionit të valvuleve që do të testohet.....	74
Figura 5.2 Vendosja e termometrave magnet në pjesët e ekspozuara të stacionit.....	79
Figura 5.3 Vendosja e termometrave për matjen e temperaturës së tokës dhe tubit.....	79
Figura 5.4 Matësi temperaturës së ujit përpara se të filloj Procesi i mbushjes.....	80
Figura 5.5 Transportimi i ujit nga depozita e ujit tek stacioni.....	80
Figura 5.6 Pika e mbushjes së stacionit me ujë.....	80
Figura 5.7 Gjatë Procesit të mbushjes me ujë.....	80
Figura 5.8 Skema e mbushjes së stacionit ABV-25 me ujë.....	80
Figura 5.9 Momenti kur Pigu mbërrin në kokën testuese.....	81
Figura 5.10 Instrumente që do përdoren për testim.....	82
Figura 5.11 Filloj presimi deri në 50% të testit të presionit me 2 bar/min.....	83
Figura 5.12 Presioni arriti 65 bar.....	83
Figura 5.13 Kontrolluam seksionin për rrjedhje në të gjithë komponentët e ekspozuar.....	84
Figura 5.14 Nga DWT presioni arriti 80% te testit të presionit.....	84
Figura 5.15 Kontroll vizual në të gjitha seksionet e ekspozuara.....	84
Figura 5.16 Asnjë rrjedhje nuk u konstatua nga kontrolli vizual.....	84
Figura 5.17 Presioni në stacion është 130 bar. Filloj koha e mbajtjes nën presion për 90 min.....	84
Figura 5.18 Mbaroj koha e mbajtjes presioni në fund të saj ishte 123.5 bar.....	84
Figura 5.19 Mbaroj mbajtja për 30 min në 10 bar. Filloj presimi për testin e rrjedhjes.....	85

Figura 5.20 Presioni arriti 50% të testit të rrjedhjes me 2.3 bar/min.....	85
Figura 5.21 Presioni arriti 80% të testit të rrjedhjes me 2 bar/min.....	85
Figura 5.22 Presioni arriti 100% të testit të rrjedhjes (118 bar).....	85
Figura 5.23 Mbaroj koha e mbajtjes nën presion,.....	87
Figura 5.24 Testi në hermetizimet mbaroj.....	87
Figura 5.25 Grafiku i regjistrimit të presionit, testi i fortësisë.....	88
Figura 5.26 Grafiku i regjistrimit të presionit, testi i rrjedhjes.....	88
Figura 6.1 Vendndodhjes e termometrave,7 në total.....	109
Figura 6.2 Marrja e të dhënave nga termometrat e instaluar.....	109
Figura 6.3 Dead Weight Tester.....	110
Figura 6.4 Regjistrues Dixhital.....	110
Figura 6.5 Termometër temperature.....	110
Figura 6.6 Regjistrues Presioni.....	110
Figura 6.7 Pressure transmitter.....	110
Figura 6.8 Regjistrues temperature.....	110
Figura 6.9 Skema e mbushjes së seksionit me ujë.....	111
Figura 6.10 Marrja e ujit në Devoll.....	112
Figura 6.11 Transportimi drejt stacionit të mbushjes së ujit.....	112
Figura 6.12 Uji filtrohet dhe më pas dërgohet në depozitat e ujit.....	112
Figura 6.13 Dërgimi i ujit në seksion.....	112
Figura 6.14 Gjatë mbushjes së seksionit me ujë.....	112
Figura 6.15 Filloj rritja e presionit me 0.6 bar/min.....	113
Figura 6.16 Volumi që kërkohet për rritjen e presionit me 1 bar është 826.5litra tek 88 bar.....	113
Figura 6.17 Presioni në seksion arriti 80% e presionit të testimit.....	114
Figura 6.18 Gjatë kontrollit vizual.....	114

LISTA E TABELAVE

Tabela 3.1 Prova në tërheqje	34
Tabela 3.2 Prova në përkulje.....	35
Tabela 3.3 Prova e goditjes.....	36
Tabela 3.4 Prova e fortësisë së sipërfaqes.....	37
Tabela 3.5 Karakteristikat e ujit që do të përdoren në testim.....	48
Tabela 3.6 Metoda të testimit nën presion.....	49
Tabela 4.1 Të dhënat për seksionin.....	59
Tabela 4.2 Të dhëna për spesorin real të hot bend.....	59
Tabela 4.3 Volumet e kompresorëve.....	62
Tabela 4.4 Llogaritjet e pozicionit të pigut.....	62
Tabela 4.5 Testimi i seksionit nr 1.....	62
Tabela 4.6 Spesori real për klasën 1, 2, 3.....	65
Tabela 4.7 Përcaktimi i spesorit maksimal.....	65
Tabela 4.8 Përcaktimi i diametrit të pllakës.....	66
Tabela 4.9 Vlerësimi i gjeometrisë.....	67
Tabela 4.10 Rezultatet e procesit të tharjes.....	67
Tabela 5.1 Lista e valvuleve të ABV-25.....	74
Tabela 5.2 Pjesët e tubacionit që lidhen me stacionin në pjesën e poshtme dhe të sipërme të tij.....	76
Tabela 5.3 Volumi total i stacionit të valvuleve që do të testohet.....	76
Tabela 5.4 Aksesorët e instaluar tek ABV-25.....	77
Tabela 5.5 Valvulet e instaluar tek ABV-25.....	78
Tabela 5.6 Tubat e instaluar.....	78
Tabela 5.7 Presionet.....	79
Tabela 5.8 Llogaritja e raportit Ri/s.....	86
Tabela 5.9 Rezultatet e Testimit të Stacionit të Valvulave ABV-25.....	88
Tabela 6.1 Të dhënat e seksionit numër 2.....	102
Tabela 6.2 Pika e fillimit të seksionit.....	104
Tabela 6.3 Pika e mbarimit të seksionit.....	105
Tabela 6.4 Volumi i Seksionit 2.....	106

Tabela 6.5 Presioni max te gjithë tubave.....	106
Tabela 6.6 Llogaritjet për energjinë e akumulimit.....	107
Tabela 6.7 Llogaritja e rrezes së sigurisë sipas AS/NZS 3788.....	109

LISTA E GRAFIKEVE

Grafiku 1 Grafiku Presion- Kohë i nxjerr nga regjistrimi dixhital i presionit.....	98
Grafiku 2 Grafiku i Presionit të rrjedhjes në funksion të kohës.....	98
Grafiku 3 Temperatura e tubacionit në funksion të kohës.....	99
Grafiku 4 Temperatura mestarë e tubacionit ne funksion te kohes.....	99
Grafiku 5 Temperatura e tokës e matur nga katër termometra.....	100
Grafiku 6 Temperatura mesatare e tokës.....	100
Grafiku 7 Temperatura mesatare e ambjentit.....	101
Grafiku 8 Presionit të rrjedhjes dhe temperaturës mesatare të tubit.....	101
Grafiku 9 Ndryshimi i presionit dhe temperaturës ne 24 ore.....	102
Grafiku 10 Paraqitja grafike e seksionit që do të testohet.....	104
Grafiku 11 Profili i seksionit dhe presionit te testimit, gjate testit te fortësisë.....	122
Grafiku 12 Profili i seksionit dhe % SMYS te perdorur gjate testit te fortësisë.....	123
Grafiku 13 Profili i seksionit nr.2 dhe presionit te testimit, gjate testit te rrjedhjes.....	125
Grafiku 13 Profili i seksionit dhe % SMYS te perdorur gjate testit te rrjedhjes.....	125

ANEKSET

Aneksi 1.....	118
Aneksi 2.....	122
Aneksi 3.....	122
Aneksi 4.....	123
Aneksi 5.....	124
Aneksi 6.....	126
Aneksi 7.....	127
Aneksi 8.....	142

KREU I

VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME MBI GAZSJELLËSIN TRANS ADRIATIK PIPELINE

1.1 Hyrje

Gazsjellësi TAP është ndër projektet me të rëndësishme për Europen dhe për vete Shqipërinë. Ai është pjesë e Korridorit Jugor të gazit që do të furnizoj Europen Jugore dhe Perëndimore me gaz nga fusha Shah Denis II Azerbajxhan dhe do të transportojë 10 milion metra kub gaz natyror në vit, sasinë e nevojshme për furnizimin e 7 milion familjeve në Evropën Juglindore dhe Perëndimore.



Figura 1.1, Vendburimi i Gazesjellsit TAP (<https://www.tap-ag.al/gazsjellesi>)

TAP-i është një kompani aksionere e përbërë nga: SOCAR (Azerbajxhan, 20%), BP (Mbretëria e Bashkuar, 20%), Snam SpA (Itali, 20%), Fluxys (Belgjikë, 19%), Enagás (Spanjë, 16%) dhe Axpo (Zvicër, 5%); këto kompani janë të njohura në fushën energjitike dhe me një përvojë të gjatë për realizimin e projekteve ndërkombëtare¹.




Figura 1.2, Aksionerët e Gazesjellsit TAP (<https://www.tap-ag.al/gazsjellesi>)

¹[https://www.tapag.com/assets/07.reference_documents/english/Project%20Finance%20Disclosure/Cumulative%20Impact%20Assessment%20Executive%20Summary%20\(Albanian%20Translation\).pdf](https://www.tapag.com/assets/07.reference_documents/english/Project%20Finance%20Disclosure/Cumulative%20Impact%20Assessment%20Executive%20Summary%20(Albanian%20Translation).pdf)

Gazsjellësi Trans Adriatik Pipeline(TAP) fillon ndërtimin e tij në afërsi të Kipoit në kufirin midis Turqisë dhe Greqisë, nga ku ai aty bashkohet me Gazsjellësin Trans Anatolian (TANAP). Perpara se të arrij në territorin e Shtetit të Shqipërisë ai kalon në pjesën veriore të Greqisë, e cila është pjesa më e gjatë e këtij projekti. Gjatësia e Gazsjellësit TAP është 878 km, nga të cilat 550 Km përshkojnë territorin e Greqisë, 215 Km përshkojnë Shqipërinë, 105 Km kalon në Detin Adriatik dhe mbërrin në tokën Italis Jugore duke plotësuar 8 Km e tij të fundit. Për sa i përket relievit pika më e lartë e TAPit ndodhet në malet shqiptare, 2.100 metra mbi nivelin e detit, ndërsa pika më e ulët ndodhet në thellësi të ujërave të Adriatikut, 820 metra nën nivelin e detit². Gjatësia e gjurmës në Shqipëri është 215 km dhe do të nisë në Bilisht qendër , në rajonin e Korçës në kufi me Greqinë më pas në Korçë duke vazhduar për në Çorovodë, Berat dhe duke përfunduar në Seman të Fierit dhe më pas duke përshkruar Detin Adriatik përfundon në Italinë Jugore për tu lidhur me rrjetin Italian të gazit natyror³.




Figura 1.3, Gjurma e Gazsjellësit TAP Shqipëri(<https://www.tap-ag.al/gazsjellesi/harta-e-gjurmës>)

Tap ka filluar fazën e ndërtimit në 2016 dhe do ta përfundojë atë në dhjetor 2019. Nga Janari i 2019 deri në dhjetor të 2019, kjo kohë do të jetë faza e komisionimit në të cilën do të vihet në punë gazsjellësi. Në janar të 2020 do të kalojë gazi i parë në Shqipëri⁴.

² <https://www.tap-ag.al/gazsjellesi/harta-e-gjurmës>

³ https://www.tap-ag.com/assets/07.reference_documents/albanian/scoping_document/albania/TAP-FEED-AL-EIA-REP-7028_ESIA_Scoping_Rep_Albania.pdf

⁴ <https://www.tap-ag.al/gazsjellesi/plani-i-projektit>

KREU II

PROÇESET E NDËRTIMIT TË GAZSJËLLSIT TAP- SHQIPËRI

2.1 Fazat e ndërtimit të Gazsjellësit TAP :

Ndërtimi i gazsjellësit TAP kalon në këto procese :

- Procesi i pastrimit dhe sistemimi i gjurmës.
- Procesi i shtrimit i tubave.
- Procesi i harkimit të tubave në të ftohtë.
- Procesi i saldimi dhe testimi i tubave me reze ultrasonike.
- Procesi i lyerjs së nyjeve të salduara me material mbrojtës.
- Procesi i gjurmimit të kanalit.
- Procesi i uljes së tubit në toke.
- Procesi i mbulimit të tubacionit nën tokë.
- Procesi i kthimit të tokës në gjendje fillestare.

Më poshtë po analizojmë të gjitha proceset e ndërtimit të gazsjellsit.

2.2 Procesi i pastrimit dhe sistemimit të gjurmës.

Faza e parë e ndërtimit të gazsjellësit është pastrimi dhe sistemimi i gjurmës, i cili është procesi i parë i punës për ndërtimin e gazsjellësit ku paraprakisht përfshihet piketimi i gjurmës nga topografët si dhe skanimi i saj nga ushtria e Shqipërisë për ndonjë municion të paplasur. Më pas fillohet me procesin e pastrimit të gjurmës duke hequr vetëm 30 cm tokë e punueshme dhe grumbullimi veçmas i saj sipas projektimit. Në fund bëhet nivelimi i tokës për kalimin e makinerive si dhe fazat e tjera të punimeve. Pajisjet kryesore që kryejnë këtë proces janë ekskavatorët që bëjnë gjurmimin si dhe buldozieret të cilët bëjnë sheshimin dhe nivelimin e gjurmës. Gjerësia tipike e gjurmës është 38 m por ajo varjon sipas rëndësisë së të vjelave, pozicionit gjeografik ose faktorëve të tjerë teknik. Gjatë këtij procesi shumë e rëndësishme është identifikimi i rrugëve të aksesit, linjave elektrike apo kabllot e internetit si dhe tubacionet e nëndheshme të ujërave të pastra dhe të papastra. Gjatë këtij procesi një rol të rëndësishëm ka monitorimi për ruajtjen e ambientit ekzistues, monitorimi nga ana sociale e procesit si dhe monitorimi arkeologjik për zbulime të mundshme historike përgjatë gjurmës. Të gjitha proceset duhet të kryhen duke respektuar rregullat e sigurimit teknik në punë⁵.

⁵ LOLER -UK Lifting Operations & Lifting Equipment Regulations 1998.



Fig.2.1 , Pastrimi dhe sistemi gjurmës

2.3 Procesi i shtrimit dhe harkimit të tubave

Ngjitja dhe vendosja e tubave bëhet nëpërmjet disa makinerive të fuqishme me vakum. Gjatë këtij procesi tubi duhet të pozicionohet mbi disa binare druri për të ruajtur një distancë të caktuar nga toka, si dhe mbrojtja nga kontakti nëpërmjet thasëve të mbushur me rërë të cilët bëjnë të mundur ruajtjen e veshjes së tij nga dëmtime të ndryshme. Shtrimi i tubave bëhet përgjatë gjithë gjurmës përveç në zona ku kryqëzohet me rrugë ose kanale të ndryshme, në të cilët tubat grumbullohen në zonën më të afërt dhe pastaj shtrohen në një moment të dytë.



Fig.2.2, Shtrimi i tubave

Harkimi i tubave është një proces mekanik i cili kryhet me makineri të posaçme dhe u jep tubave një kënd të caktuar duke përthyer atë mekanikisht në të ftohtë. Si fillim tubat e harkuar janë evidentuar përgjatë gjurmës nga grupi i topografëve, në bazë të dezajnit dhe relievit përcaktohet lloji i harkimit. Kemi pesë lloje harkimesh: të lugët, të mysët, harkim djathtas, harkim majtas si dhe harkime të dyfishta. Këto përthyerje të tubit mund të kenë kombinime të ndryshme mes tyre sipas territorit. Harkimi maksimal në të ftohtë për projektin tonë arrin deri në 13 gradë.

Një gjë shumë e rëndësishme e këtij procesi është dhe rishtrimi i tubit preciz sipas projektit për të ndihmuar procesin e saldimit të vazhdoj rrjedhshëm, në të kundërt mund të kemi devijime të ndryshme përgjatë gjurmës⁶.



Figura 2.3, Harkimi i tubave

2.4 Procesi i saldimit dhe testimit të tubave me rreze ultratinguj

Saldimi është rruga më ekonomike dhe eficiente për të krijuar nyje metalike permanente. Është rruga e vetme për të bërë dy ose më shumë detale metalike një trup të vetëm. Në të njëjtën kohë saldimi klasifikohet si një proces industrial i rëndësishëm së lartë ku brenda tij përfshihen me shume shkenca sesa çdo proces tjetër industrial. Duke patur parasysh kompleksitetin e këtij procesi, padyshim që edhe në projektin TAP ky proces studiohet dhe monitorohet në mënyrë të vazhdueshme.

Tubat në këtë projekt janë prej një diametri të jashtëm 48” (1219mm) dhe me gjatësi prej 12m dhe 18m me spesorë që variojnë nga 17.5mm/21mm/24.9 dhe 30.9mm. Materiali bazë i përdorur është një çelik pak i lidhur me karakteristika të larta mekanike, marka e së cilës është L485ME sipas ISO 3138. Sipas udhëzuesit për grupimin e materialeve prej çeliku ISO 15608 ky material bën pjesë në grupin 2.2, çelik i formuar me trajtim termiko-mekanik me kokërriz të imët me sforcime të lejuara $ReH > 460 \text{ N/mm}^2$. Këto tuba janë të parafabrikuara me karakteristikat cilësore të lart përmendura nga ndërmarrje të specializuara duke respektuar standardin ndërkombëtar për sistemet e transportit me tubacion të naftës dhe gazit natyror ISO 3138 grada PSL 2.

⁶ D3_A_OIK 4303 - 199-2 – Transport and Stringing of Pipes.



Fig 2.4 Faza pas përfundimit të hapjes së tubove



Fig 2.5 Faza pas përfundimit të saldimit

Realizimi i saldimit të tubave në një mjedis kompleks operimi përgjatë gjurmës së tubacionit kryhet nga një ndërmarrje e vërtetë lëvizëse ku brenda saj ka 9 reparte me nga një proces të dedikuar. Ky proces realizohet me një kah lëvizje, ku çdo proces ka si produkt hyrjen e procesit tjetër deri në prodhimin e nyjes së salduar.



Fig 2.6 ,Gjatë saldimit të tubacionit TAP

Zmusimi (përgatitja e buzëve të saldimit)

Zmusimi kryhet me anë të punimit mekanik duke krijuar një zmuso të tipi "J" sipas EN ISO 15607 me ndihmën e një pajisje tornuese ku kryhen 3 operacione tornuese në të njëjtën kohë duke kryer vetëm një kapje. Këto makineri shfrytëzojnë një kombinim sistemesh mekaniko-hidraulike, ku kryhen një sërë operacionesh. Precizioni i punimit arrin me një tolerancë $\pm 0.13\text{mm}$. Konfigurimi i zmusos dhe dimensionet duhet të jenë në përputhje me procedurën e saldimit në të cilën zmuso është dimensionuar për çdo spesor ku dhe janë përcaktuar edhe tolerancat përkatëse. Më pas çdo zmuso i nënshtrohet një inspektimi të dimensioneve dhe pastërtisë së sipërfaqes ku dhe është hapi përfundimtar për tu pranuar në të kundërt rikthehet për rizmusim.



Fig 2.7 ,Zmusimi




Fig 2. 8., Paisja tornuese e pergatitjes së zmusos së saldimi




Fig.2.9, Zmusimi

Përgatitja e saldimi U mund të prodhohet vetëm nga përpunimi mekanik që ka kosto të konsiderueshme. Megjithatë, sasia e përftuar dhe tolerancat e forta të fituara në këtë rast sigurojnë një montim më të mirë sesa në rastin e përgatitjes së zmusos V në mënyrë konvencionale. Kjo përgatitje kërkon më pak material mbushës për të përfunduar nyjen e salduar dhe kjo çon në ulje të deformimeve dhe tensionimeve të mbetura nga saldimi në nyjen e salduar.

Demagnetizimi

Për shkak të fërkimit gjatë përgatitjes së zmusos nga paisja tornuese pjesa fundore e tubit mund të magnetizohet dhe për këtë arsye çdo zmuso inspektohet që të ketë një nivel magnetizimi më të ulët se 50 gauss. Demagnetizimi njihet ndryshe si procesi i zvogëlimit ose eliminimit të një fushe magnetike të mbetur. Është një proces i rëndësishëm për të eliminuar çrregullimin e harkut elektrik gjatë saldimi.



Fig 2.10 , Demagnetizimi

Degaussing njihet ndryshe si procesi i demagnetizimit, i cili është procesi i zvogëlimit ose eliminimit të një fushe magnetike të mbetur në materialin bazë. Në kushte të caktuara, harku elektrik ka tendencë që të drejtohet larg nga banja e saldimit, duke e bërë të vështirë për të prodhuar një saldim cilësor. Ky fenomen, i quajtur çrregullim në harkut elektrik, është si rezultat i shqetësimeve magnetike që rrethojnë harkun e saldimit. Megjithëse çrregullimi i harkut elektrik nuk mund të eliminohet gjithmonë, por mund të kontrollohet ose të reduktohet në një nivel të pranueshëm nga fushat e mbetura magnetike, sjellin dhe shqetësime për inspektimet me radiografi (X-Ray).

Pastrimi

Pastrimi i detaleve që do të saldohen nga shtresa okside e petëzimit, graso dhe vajra sjellin mënjanimin e krisjeve gjatë fazës së ngurtësimit.




Fig.2.11 ,Pastrimi

Zmuso pastrohet në mënyrë që të mos ketë asnjë kontaminim. Shtresa okside që formohet nga petëzimi përmban sasi të lartë squfuri, vajrat dhe grasot mund të furnizojnë me karbon të mjaftueshëm që të krijohet krisje në fazën e solidifikimit. Gjithashtu kontaminime nga metale me pikë të ulët shkrirje si Sn, Cu, Zn duhet të mënjanohen.

Pas përfundimit të de-magnetizimit zmuso pastrohen nga ashkla të mbetura në 20 mm të pjesës fundore të tubit, gjithashtu zmuso përpara montimit duhet të jetë e pastruar plotësisht nga graso, vajra, lëngje, shtresa okside si dhe dëmtime mekanike, të cilat të gjitha ndikojnë drejtpërdrejtë në cilësinë e saldimit. Në këtë proces përdoren pajisje elektrike manuale. Më pas çdo përgatitje i nënshtrohet një kontrolli vizual ku jep miratimin për vazhdimin në fazën pasardhëse.

Parangrohja

Parangrohja është një proces delikat ku ne marrim efekte të dobishme për saldimit, por ekzekutimi në mënyrë jo të duhur mund të na sjellë një degradim të materialit bazë. Efektet e dobishme që marrim janë:

- A. Kontroll i kohës së ftohjes në zonën e ndikuar termikisht (HAZ)
- B. Kontroll për krijimin e strukturave martensite
- C. I jepet kohë e mjaftueshme hidrogjenit të largohet nga struktura
- D. Ul shkallën e tensionimeve të mbetura
- E. Eliminimin e lagështisë në zonën që do të saldohet
- F. Përmirëson shkrirjen gjatë saldimit

Për këto arsye kaq të rëndësishme për përcaktimin e temperaturës së parangrohjes merren parasysh 4 faktorë

- Karboni ekuivalent i materialit bazë $CET = C + \frac{Mn+MO}{10} + \frac{Cr+Cu}{20} + \frac{Ni}{40} \%$

Me anë të cilës llogaritet temperatura e parangrohjes duke patur parasysh CET:

$$T_{pCET} = 750 \times CET - 150(^{\circ}C)$$

- Spesori i materialit bazë me anë të cilës llogaritet temperatura e parangrohjes duke patur parasysh T_{pd} ku “d” është spesori i llamarinës.

$$T_{pd} = 160 \times \tanh\left(\frac{d}{35}\right) - 110(^{\circ}C)$$

- Përmbajtja e hidrogjenit në materialin bazë me anë të cilës llogaritet temperatura e parangrohjes duke patur parasysh T_{pHD} ku “HD” është përmbajtja e hidrogjenit.

$$T_{pHD} = 62 \times HD^{0.35} - 110(^{\circ}C)$$

- Energjia e lëshuar gjatë saldimit Q (KJ/mm) $Q = \frac{\text{Volts} \times \text{Amp}}{v \left(\frac{\text{mm}}{\text{sec}} \right) \times 1000}$ me anë të cilës llogaritet temperatura e parangrohjes duke patur parasysh T_{pQ}

$$T_{pQ} = (53 \times \text{CET} - 32) \times Q - 53 \times \text{CET} + 32 (^{\circ}\text{C})$$

Me anë të këtyre elementëve llogarisim temperaturën e parangrohjes duke patur parasysh të 4 faktorët

$$T_p = T_{p\text{CET}} + T_{p\text{HD}} + T_{pQ} + T_{p\text{d}} (^{\circ}\text{C})$$

Për këtë arsye ngrohja me induksion është e kontrolluar nga një telekomand që e mban temperaturën konstante në parametrat e kërkuar në 80°C ku saldimi nuk mund të fillojë nën temperaturën 50°C dhe mbi 120°C⁷.

Parangrohja përfshin ngrohjen e materialit bazë (80mm fundor të tubit) përpara fillimit të saldimit në një temperaturë ndërmjet 50°C-120°C me anë të induksionit. Parangrohja është një proces delikat ku ne marrim efekte të dobishme për saldimin, por ekzekutimi në mënyrë jo të duhur mund të na sjellë një degradim të materialit bazë. Për këtë arsye induktori është i kontrolluar nga një pajisje që e mban temperaturën konstante në parametrat e kërkuar.



Fig 2.12 ,Parangrohja me ane të induksionit

Montimi

Montimi i tubave kokë më kokë kryhet nëpërmjet një pajisje pneumatike që vepron brenda tubit. Ky montim siguron një konfiguracion U me kënd 8-12°. Përgatitja mekanike na siguron një përputhshmëri të lartë në montim duke siguruar një montim kokë më kokë me hapësirë 0-1mm ndërmjet detaleve. Gjithashtu cilësia e

⁷ BS EN 1011-2: 2001: Welding. Recommendations for welding of metallic materials. Arc welding of ferritic steels', British Standards Institution, 2001.

prodhimit të tubove duke na garantuar një perimetër me toleranca $\pm 3\text{mm}$ dhe ovalitet $\pm 5\text{mm}$, ndikojnë që të kemi një montim perfekt të detaleve.



Fig 2.13, Montimi

Saldimi

Pas përfundimit të fazave të lart përmendura bashkë me kontrollet e cilësisë për çdo fazë jepet miratimi për fillimin e procesit të saldimit. Saldimi kryhet në njësi të posaçme ku kanë të gjithë teknologjinë e nevojshme për të mbarvajtur procesin. Saldimi i tubacionit në projektin TAP kryhet nëpërmjet procesit me gas mbrojtës 135 (MAG) dhe me mbështetje provizore Cu (bakri). Ky proces klasifikohet si automatik ku nënkupton se të gjitha parametrat e saldimit (Intensiteti, tensioni, shpejtësia e lëvizjes, shpejtësia e telit, fluksi i gazit mbrojtës, oshilimi i pincës së saldimit, gjatesia e harkut) janë të para programuara ku kontrollohen nga sistemet përkatëse dhe përzgjidhen nga operatori në varësi të spesorit dhe pozicionit të saldimit.



Fig 2.14,Gjatë procesit të saldimit automatik

Kontrolli vizual i sipërfaqes së nyjeve të salduara

Perimetri i nyjes së salduar kontrollohet nga ana vizuale. Të gjitha saldimet përpara ekzaminimit vizual duhet të jenë të pastra nga kontaminimet si ndryshku, skorje, spërkatjeve të lëshuara gjatë saldimit, vajra etj. Më pas një inspektor i kualifikuar bën evidentimin dhe vlerësimin e ndërprerjeve të vazhdueshmërisë së sipërfaqes.

Ky inspektim kryhet menjëherë pas përfundimit të saldimit, ku kryhet një vlerësim paraprak i integritetit të saldimit. Ndërprerjet më të zakonshme të vazhdueshmërisë përfshijnë: mos shkrirje, mbushje jo plote, krisje, dëmtime mekanike, mos penetrim etj. Një arsye për këtë është se ndërprerjet e sipërfaqes, të cilat mund të zbulohen nga inspektimi vizual, nganjëherë mund të shkaktojnë keqinterpretim të rezultateve NDT ose të maskojnë ndërprerje të tjera brenda trupit të saldimit. Nëse vizualisht nuk mund të përcaktohet defekti atëherë aplikohen teknika të tjera të provave pa shkatërrim për kontrollin sipërfaqësor siç janë: kontrolli me penetrant (PT) ose magnetik (MT).

Pas vlerësimit të nyjes së salduar saldimi lihet të ftohet që më pas ti nënshtrohet një inspektimi volimetrik⁸.



Fig 2.15 , Tegeli i saldimit gjatë kontrollit dimensional dhe pas inspektimit vizual

Ftohja

Ftohja e nyjes së salduar është një proces mjaft i rëndësishëm që ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e saldimit. Për këtë arsye menjëherë pas përfundimit të inspektimit vizual vendoset një mbështjellje termoizoluese me anë të cilës maksimizojmë kohën e ftohjes në temperaturë ambiente. Arsyeja kryesore e kontrollit të ftohjes është sepse temperatura në nyjen e sapo përfunduar është ende mbi 100°C, në të cilën temperaturat e difuzionit të

⁸ ELOT EN 12732 Gas infrastructure – Welding steel pipework – Functional requirements


hidrogjenit janë dukshëm më të larta se në temperaturën e ambientit. Reduktimi i hidrogjenit zvogëlon rrezikun e krisjeve në nyjet e salduara⁹.



Fig 2.16, Vendosja e mbështjelljes termoizoluese

Kontrolli volumetrik i nyjeve të salduara

Kontrolli volumetrik i saldimit kryhet me atë të teknikës së provave pa shkatërrim me ultratinguj ku ekzaminimi 100% i perimetrit të saldimit rrethor kryhet në kantier, pasi saldimet gjatësore janë verifikuar në fabrike gjate fabrikimit të tubave. Ky ekzaminim përfshin evidentimin, matjen dhe vlerësimin e defekteve që ndodhen në seksionin e saldimit në brendësi ashtu dhe në sipërfaqe. Ky inspektim kryhet nga një sistem i automatizuar dhe integruar i inspektimit me ultratinguj (AUT) që kombinon teknikat PA(phased array) dhe TOFD (time of flight diffraction), për të rritur probabilitetin e zbulimit (POD) dhe zvogëlimin e probabilitetit të dështimit (POF)¹⁰.



⁹ BS EN 1011-2: 2001: Welding. Recommendations for welding of metallic materials. Arc welding of ferritic steels', British Standards Institution, 2001.

¹⁰ The Welding Institute, Training & Examination Services, <https://www.twi-global.com/>




Fig 2.17 ,Teknika PA dhe TOFD për inspektimin e rrënjes

2.5 Procesi i lyerjes se nyjeve te salduara me material mbrojtës

Përdorimi i veshjes për mbrojtjen e strukturave të çelikut.

Veshja e tubit është procesit i mbrojtjes së sipërfaqes së substratit nga agjentet kimik duke eliminuar proceset elektrokimike që shoqërohen me degradimin e materialit bazë në struktura kimike me energji potenciale të ulët. Kur metali korrodohet për shkak të reaksioneve kimike që zhvillohen, produkti përfundimtar i procesit do ti përngjaj metalit në xeheror i cili do të jetë i rrethuar nga komponime si sulfatet, karbonate, okside etj. Një ndër elementët më të rëndësishëm për mbrojtjen ndaj korrozionit është edhe veshja e materialit me element të cilët nuk kanë ndërveprim me mjedisin duke krijuar një barrier ndërmjet dy sistemeve dhe eliminimin e kontaktit të drejtpërdrejt të tyre duke ulur intensitetin e korrozionit¹¹.




Fig.2.18 , Veshja e tubit në projektin TAP

¹¹ ISO 21809-3 Petroleum and natural gas industries – External coatings for buried or submerged pipelines used in pipeline transportation systems – Field joint coatings.

Veshja e tubit për mbrojtje ndaj korrozionit:

Së pari: aplikohet FBE “Fusion Bonded Epoxy” që është një primer epoksid që aplikohet në gjendje pudre në temperatura 180°C deri në 250°C duke formuar një film prej 60µm. Kjo shtrese prajmeri bën të mundur mbrojtjen ndaj korrozionit por edhe një adezion më të mirë të Polietilen(PE) apo Polipropilen(PP) në sipërfaqe. Së dyti: aplikohet 3LPE/3LPP “3 shtresa polietilen ose 3 shtresa polipropilen” i cili ka veti fizike dhe kimike të shkëlqyera për mbrojtjen e strukturave të metalit ndaj korrozionit. Materiali që përdoret është një PE me densitet të lartë, shtresa e krijuar është me një trashësi 5mm dhe me një fortësi “Shore D – 65” në temperaturë 22°C. PE i përdorur është produkt termoelastik që thjeshton riparimet në rast dëmtimesh mekanike në veshjen baze të tubit¹².

Veshja e nyjeve të salduara:

Qëllimi i këtij procesi është që të përshkruaj metodat e përdorura lidhur me fushën e veshjeve të nyjeve të salduara në projektin TAP duke u mbështetur në standardet përkatëse.

Para nisjes të çfarëdo aktiviteti, një inspektim vizual i bëhet çdo nyje apo metali të ekspozuar. Defektet sipërfaqësore të cilat ndikojnë në integritetin e strukturës së tubacionit si dëmtimet mekanike eliminohen. Sipërfaqja e metalit duhet të jetë e pastër dhe çdo prezence vajrash apo të kripërave të tretshme duhen pastruar. Gjatë kësaj faze zhvillohet një test për të përcaktuar “nivelin e kripërave të tretshme” që mund të jetë kloride apo sulfite, me një shkallë pranueshmërie 0 në 2µg/cm² ¹³.



Pas matjes së përqëndrimit të kripërave të tretshme rezultati ishte 0.1µg/cm², testi pranohet dhe dokumentohet.

Fig. 2.19, Inspektimi Fillestar

Në rast se kjo vlerë do të tejkalohet, nyjet do të nënshtrohen një procesi pastrimi me ujë në presion të lartë për të ulur nivelin e kripërave të tretshme.

¹² EN 10290 Steel tubes and fittings for onshore and offshore pipelines. External liquid applied polyurethane and polyurethane-modified coatings SSPC

SP1 Society for Protective Coatings – Solvent Cleaning.

¹³ ISO 8502-9 Preparation of steel substrates before application of paints and related products - Tests for the assessment of surface cleanliness: Field method for the conductometric determination of water-soluble salts.

Para-ngrohja para procesit të pastrimit me rërë abrazive.

Lagështia relative dhe temperatura e ambientit kontrollohen duke përdorur një hidrometër për të përcaktuar pikën e vesës para aplikimit të veshjes. Në raste të caktuara sipërfaqja parangrohet për të paktën një ΔT më të lart se 3°C para pastrimit me rërë abrazive. Rëndësia e këtij procesi është që të bëjë të mundur parandalimin e krijimit të lagështisë në sipërfaqe gjatë procesit të pastrimit me rërë. Monitorimi dhe realizimi i parangrohjes bën të mundur që të kemi një diferencë temperaturash ndërmjet sipërfaqes së metalit dhe pikës së vesës duke eliminuar mundësinë e krijimit të vesës në sipërfaqen dhe rrjedhimisht formimin e ndryshkut.



Fig. 2.20 , Parangrohja

Përgatitja e sipërfaqes së metalit

Çdo nyje e cila i nënshtrohet procesit të veshjes duhet paraprakisht të pastrohet me rërë abrazive. Ajri i kompresuar për procesin e pastrimit duhet të mos ketë përmbajtje vaj, lagështie të kondensuar apo papastërti të tjera¹⁴. Një test zhvillohet para nisjes së pastrimit me rërë abrazive për përcaktimin nëse ka përmbajtje vaji në ajrin e kompresorit. Kjo bën të mundur që të eliminohet mundësia e ndotjes së sipërfaqes gjatë procesit të pastrimit. Sipërfaqet e çelikut pastrohen me rërë abrazive deri në një shkallë pastrimi $\text{SA} - 2^1$ (metal i bardhë)¹⁵.

Inspektim vizual zhvillohet për çdo nyje të pastruar për të identifikuar që pastrimi është realizuar në përputhje me specifikimet dhe sipërfaqja nuk ka prani korrozioni.

¹⁴ ASTM D 4285 Standard Test Method for – Indicating Oil or Water in Compressed Air.

¹⁵ ISO 8501-1 Preparation of steel substrates before application of paints and related products -- Visual assessment of surface cleanliness Part 1.




Fig.2.21 ,Përgatitja e sipërfaqes së metalit

Pas pastrimit me rërë abrazive sipërfaqja i nënshtrohet një pastrimi me ajër më presion të lartë për të larguar të gjitha pluhurat dhe papastërtitë që mund të mbeten në sipërfaqe dhe niveli i pluhurit në sipërfaqen e pastruar duhet të kontrollohet nëse është në përputhje me specifikimet teknike¹⁶.

Rëndësia e procesit të pastrimit të pluhurave të mbetura pas pastrimit me rërë abrazive bën të mundur që të kemi një adezion më të mirë ndërmjet sipërfaqes së metalit dhe veshjes poliuretan që do të aplikohet. Profili i sipërfaqes $SA - 2\frac{1}{2}$ duhet të jetë në rangun 70 – 110 μm në përputhje me të dhënat teknike të produktit që do të përdoret për veshjen e tubit si dhe me specifikimet teknike¹⁷. Rritja e adezionit të dy strukturave të cilat nuk kanë tërheqje molekular realizohet nëpërmjet interferencës molekular nëpërmjet ashpërsimit të sipërfaqes në të cilën do të aplikohet PUR. Rëndësia e procesit të matjes së profilit të sipërfaqes është një garanci për një adezion më të mirë në sipërfaqe.



Fig.2.22 , Profili i sipërfaqes.

¹⁶ ISO 8502-3:2017, Preparation of steel substrates before application of paints and related products - Tests for the assessment of surface cleanliness - Part 3: Assessment of dust on steel surfaces prepared for painting (pressure-sensitive tape method).

¹⁷ ISO 8503-5 Preparation of steel substrates before application of paints and related products Replica tape method for the determination of the surface profile.

Para mbivendosjes së shtresave të PE dhe veshjes poliuretan paraprakisht fillon përgatitja e PE. Rëndësia e këtij procesi është që të bëjë të mundur të kemi një adezion sa më të mirë ndërmjet dy veshjeve kimikisht të ndryshme. Realizimi i këtij procesi bëhet duke ashpërsuar sipërfaqen e PE në mënyre mekanike.

Një seksion prej 50mm i nënshtrohet procesit të pastrimit me rërë për ti dhënë sipërfaqes së PE ashpërsi për të rritur shkallën e adezionit.

Në mënyrë që të përshpejtohet ndërveprimi i 2 komponentëve të PUR, sipërfaqja në të cilën do të aplikohet veshja i nënshtrohet një procesi ngrohje me induksion në temperatura ndërmjet 60°C në 80°C. Temperatura monitorohet me një termometër kontakti.

Veshja e nyjeve realizohet nëpërmjet aplikimit të një produkti poliuretan bikomponent me baze solventi. Sistemi i aplikimit është automatik duke dhënë një rezultat të shkëlqyer i cili ripërsëritet nga nyja në nyje. Njësia e aplikimit automatik vendoset në qendër të nyjes së salduar e drejtuar nga një lazer për pozicionimin e tij. Rezultati përfundimtar është një film me një DFT uniformë në nyjen e aplikuar. Monitorimi i procesit bëhet nëpërmjet kontrollit të temperaturës dhe presionit gjatë procesit të aplikimit, për të siguruar që procesi të jetë nën rekomandimet e prodhuesit¹⁸.



Fig. 2.23, Aplikimi i veshjes

Pas aplikimit një inspektim vizual i bëhet çdo nyje për të garantuar që rezultati përfundimtar është ai i kërkuari dhe që nuk kemi defekte vizuale në nyje.

2.6 Procesi i hapjes së kanalit të tubit.

Në projektin TAP për gjurmimin e kanalit përdoren teknika të ndryshme në varësi të terrenit. Në terrene me tokë të butë hapja e kanalit bëhet me anë të ekskavatorëve ndërsa në terrene shkëmbore hapja e kanalit bëhet

¹⁸ ISO 4624 -Paints and varnishes – Pull-off test for adhesion.

me anë të shpërthimit të eksplozivëve. Qendra e gërmimit të kanalit identifikohet dhe shënohet nga një ekip studimi para-ndërtimor, të cilët marrin në konsiderate vendndodhjet e treguara në planin e shtrimit të tubacionit. Lartësia e kanalit duhet kryer sipas vizatimeve. Gjerësia e kanalit e matur në pjesën fundore duhet të jetë minimalisht sa diametri i tubit duke shtuar 200 mm tolerance në çdo krah. Pjesa fundore e kanalit duhet të ketë një profil të lëmuar pa gurë, shkëmbinj apo objekte të mprehtë të cilët mund të dëmtojnë veshjen e tubit. Materiali i gërmuar duhet të vendoset në anën e kanalit të paktën 1 metër nga buza e kanalit që të parandalohet mbingarkimi dhe shembja e kanalit¹⁹.



Fig. 2.24, Hapja e kanalit

2.7 Procesi i uljes së tubit në tokë

Ulja në kanal e tubit bëhet me anë të makinerive të quajtura side-booms. Përpara se të fillojë ulja e tubit sigurohet që kanali të jetë i pastër nga gurët ose objektet e mprehta dhe kryhet testi holiday i pjesës që do të

¹⁹ Natural Pipeline Construction, Wil Stanton & Angela Stanton

ulet për të parë nëse ka defekte në veshjen e tubit. Për të mbrojtur veshjen e tubit gjatë uljes, në terrenet shkëmbore fundi i kanalit mbushet me material të butë prej 200 mm.

Për uljen e tubit përdoren 7 – 9 makineri në varësi të gjeometrisë dhe trashësisë së tubit. Distanca maksimale e pikave të mbështetjes së tubit nuk duhet të kalojë 18 metra. Ky proces kërkon koordinim dhe njohje të mirë të shenjave të duarve midis super vizorëve dhe operatorëve të makinerive²⁰.



Fig. 2.25 ,Ulja e Tubit

2.8 Procesi i mbulimi të tubit dhe kthimi i tokës në gjendjen fillestare

Pas uljes së tubit procesi tjetër është ai i mbulimit të tubit me dhe i cili është një hap mjaft kritik për të siguruar integritetin e tubacionit. Si fillim duhet të sigurohet që tubi është plotësisht i mbështetur në shtratin e kanalit gjatë gjithë gjatësisë së tij. Shtrati i kanalit duhet të përbëhet nga një material mbushës i cili nuk e dëmton veshjen e tubit. Me pas fillon mbushja e kanalit deri në një lartësi minimale prej 300 mm mbi pjesën e sipërme të tubit. Mbushja kryhet me një material që përbëhet nga gurë pa tehe të mprehta jo më të mëdhenj se 25mm x 50mm. Gjatë këtij procesi kryhet dhe shtrimi i 2 tubave HDPE të fibrës optike. Pas shtrimit të këtyre tubave

²⁰ The INGAA Foundation, Inc. A Practical Guide for Pipeline Construction Inspectors.

bëhet dhe shtrimi i një shiriti sinjalizues me gjerësi 600 mm. Shtresa e fundit e mbulimit të tubit bëhet me materialin e përftuar nga gërmimi duke mos lejuar materialet me madhësi më të madhe se 300 mm.

Gjithashtu në terrene të pjerrëta, si një masë për kontrollin e erozionit, para procesit të mbulimit me dhe bëhet instalimi i shkumës së poliuretanit²¹.



Fig.2.26, Mbulimi i tubit dhe kthimi i tokës në gjendjen fillestare

²¹ ISO 3183:(last edition), Petroleum and natural gas industries – Steel pipe for Pipeline transportation systems.

KREU III

ANALIZA E PROCESEVE QË NDIKOJNË NË INTEGRITETIN E TUBACIONEVE TË GAZIT. RASTE STUDIUMI- GAZSJELLËSI TAP SHQIPËRI.

3.1 PROCESI I SALDIMIT

Qëllimi i kësaj analize është që të evidentoj fenomenet që mund të sjellin shqetësim për integritetin e strukturës në tubacionin TAP. Saldimi i tubacionit në projektin TAP kryhet nëpërmjet procesit me gaz mbrojtës 135 (MAG) automatik që bën pjesë në grupin e saldimeve me shkrirje të materialit bazë ashtu dhe materialit mbushës, ku përdoret edhe një mbështetje provizore Cu (bakri) për rrënjën e saldimit. Për faktin që ky është proces që përfshin aspektin kimik, metalurgjik, fizik dhe elektrike do të analizojmë disa nga elementet e përzgjedhur që ndikojnë drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së saldimit.

- Procesi MAG – Shpejtësia që ofron ky proces ul energjinë e futur në saldim.
- Gazi mbrojtës aktiv me 20% CO₂ – Rrit temperaturën në banjë , shton penetrimin
- Tel solid d=1mm – Ul shkallën e involvimit të hidrogjenit nëpërmjet procesit të saldimit
- Tel solid – Eliminon problematikën e skories gjatë saldimit
- Proces automatik – Ul nevojën për aftësi shumë të mira të saldatorit
- Saldimi nga lart poshtë – Shpejtësi të lartë që ul deformimet dhe tensionimet nga saldimi
- Materiali mbushës me Mn dhe Ni – Rrit karakteristikat mekanike por dhe eliminon krisjet gjatë fazës së ngurtësimit.
- Shpejtësia e saldimit – Ul zonën e ndikuar termikisht.

Të gjitha testimet synojnë evidentimin, matjen dhe vlerësimin e defekteve që ndodhen në nyjën e salduar. Nga studimi i bere ka rezultuar se defekte e mundshme janë çarje, mos mbushje korrekte, mos shkrirje materiali, mos penetrim, skorie, dëmtime mekanike etj. Më poshtë do të gjeni disa shembuj se si janë evidentuar këto defekte:




Fig.3.1, Defektet ne strukturen e materialit.

Rast studimi :Vlerësimi dhe analiza e strukturës në nyjën e salduar.

Provat pa shkatërrim kanë një normë të lartë precizoni, por ka shumë aspekte që janë të pa verifikueshme nga këto teknika, kështu që për të vlerësuar nëse karakteristikat mekanike të tegelit të saldimit afrohen me karakteristikat mekanike të materialit bazë , në linjen e gazsjellësit, ne nyjën 34 të saldimit, ne kilometrit 04 (KP04 W34) u mor ky kampion për objekt studimi. Ky kampion do ti nënshtrohet provave mekanike laboratorike për verifikimin e strukturës. Më poshtë do të analizojmë një nga kampionet e përzgjedhur në mënyrë rastësore ku i është nënshtruar provave mekanike me shkatërrim për të verifikuar strukturën.



Fig.3.2, Kampioni objekt studimi, i marr në KP04 W34 të linjës së gazsjellësit.

Ky kampion i është nënshtruar provave laboratorike të realizuara në SpectrumLabs, Quality Control Laboratories (www.Spectrum-labs.gr) si më poshtë :

1. Prova në tërheqje

Kampioni i saldimit për këtë provë është marrë në pozicionin 12 dhe 6 të orës. Me anë të kësaj prove caktojmë qëndrueshmërinë në tërheqje të nyjes së salduar.




Fig.3.3, Kampioni pas proves së tërheqjes

Rezultatet e testimit të provën e tërheqjes.

Tabela.3.1, Prova në tërheqje

Prova në tërheqje				
Pajisja e testimit: SUN 60				
Referencat e kampionit		Test 1	Test 2	Pranueshmëria ²²
Dimensionet e kampionit	mm	23.03x25.00	23.73x25.04	
Sipërfaqja e seksionit të kampionit	mm ²	575.75	594.2	> 485 N/mm ² (Sforcimet e lejuara për materialin bazë)
Forca e thyerjes (Fm)	N	365025	381001	
Sforcimi i shkatërrimit (Rm)	N/mm ²	634	641.2	>SMTS 570 N/mm ² (Sforcimi i shkatërrimit për materialin bazë)

2. Prova në përkulje.

Për këtë provë në studim janë marrë dy kampione për çdo pozicione, një seksion saldimi dhe një transversal. Testi i përkuljes është një nga testet më të rëndësishme dhe më shpesh të përdorura për provat me shkatërrim, pasi mund të përcaktojë duktilitetin dhe qëndrueshmërinë e seksionit se salduar (për prezencën e porozitetit, kontaminime, apo jo vazhdueshmëri të tjera të saldimit të brendshëm). Përkulja e kampionit është përzgjedhur të bëhet nga faqja edhe nga rrënja. Përkulja nga rrënja tregon mungesën e depërtimit dhe shkrirjes nëse ka ndonjë. Pas ndërprerjes së veprimit të forcës është matur këndi i përkuljes së bashkësisë së salduar dhe ky kënd është krahesuar me këndin e përkuljes së materialit bazë.




Fig.3.4, Kampioni i provës në përkulje

²² ISO 4136:2012-Destructive tests on welds in metallic materials — Transverse tensile test

Rezultatet e testimit të provën në përkulje.

Tabela.3.2, Prova në përkulje

Prova në përkulje			
Pajisja e testimit: VEB		Dimensionet e kampionit (10x25.5)mm	
Diametri i instrumentit: φ40mm Largësia midis suporteve: 70mm Këndi kthimit: 180°			
Referencat e kampionit	Test 1	Test 2	Pranueshmëria ²³
Kampioni seksion saldimi	S’ka	S’ka	Jo indikacione > 3mm
Kampioni transversal	S’ka	S’ka	

3. Prova ne goditje.

Për këtë provë në studim janë marrë tre kampionë dhe këto seksione u morën në zonën e ndikuar termikisht(HAZ), si dhe në materialin e salduar.






Fig.3.5, Kampionet pas provës së goditjes

²³ ISO 5173:2009- Destructive tests on welds in metallic materials -- Bend tests

Rezultatet e testimit të provës ne goditje.

Tabela.3.3, Prova në goditje

Prova ne goditje.				
Pajisja e testimit: VEB 30 kpm-KV ₂				Lagështia: 48%
Dimensionet e kampionit (10x10x55)mm Tipi: V notch Temperatura: -20°C				
Referencat e kampionit	Njësia			Pranueshmëria ²⁴
Test 1	Joule	144	185	Ne -20°C 30J min Ne -20°C 40J Mes.
Test 2	Joule	126	216	
Test 3	Joule	159	17	
Mesatarja	Joule	143	199	

1. Prova e fortësisë së sipërfaqes

Për këtë provë në studim është marrë një kampion , në seksion saldimi. Për kontrollin e fortësisë kemi përdorur metodën Vickers. Në çeliqet pak të lidhur si ai i përdorur në projekt L485M, prezenca e një fortësie më shumë se 380HV do të thotë që janë krijuar mikrostruktura me sjellje të sertë si ajo martensite, ndaj zgjedhëm vlerën maksimale të pranueshmërisë jo më të madhe se 300HV ²⁵.




Fig.3.6, Kampioni i provës në goditje




Fig.3.7, Testi i fortësisë së sipërfaqes

²⁴ ISO 9016:2012, Destructive tests on welds in metallic materials — Impact tests — Test specimen location, notch orientation and examination

²⁵ BS EN ISO 9015-1:2011-Destructive tests on welds in metallic materials. Hardness testing. Hardness test on arc welded joints.

Rezultatet e testimit të provës së fortësisë së sipërfaqes.

Tabela.3.4, Prova e fortësisë së sipërfaqes

Prova e fortësisë së sipërfaqes				
Identifikimi i zonës	Zona	Matja lokale e fortësisë nr HV		
Materiali bazë	1	206	215	200
	2	215	206	215
	3	206	215	200
	4	206	200	206
Zona e ndikuar termikisht HAZ	5	215	215	215
	6	210	215	215
	7	215	221	215
	8	221	215	215
Zona e salduar	11	236	221	221
	13	221	228	236
Pranueshmëria Max 300HV				

3.2 MBROJTA PASIVE - RASTE STUDIMI.

Testimet

Pas kalimit të hapave të mësipërme dhe garantimit që çdo proces është monitoruar. Nga studimi i bërë është arritur në konkluzionin që nyja e salduar të garantojë integritetin e saj duhet ti nënshtrohet testeve të mëposhtme :

Përcaktimi i spesorit pas aplikimit:

Spesori i çdo nyje që i është nënshtruar procesit të veshjes kontrollohet dhe dokumentohet, kërkesat për këtë kategori produkti poliuretan për mbrojtjen ndaj korrozionit referuar studimit të bërë kërkon një spesor ndërmjet 1500 në 5000µm në mënyrë që të mos cenohet integriteti i nyjës së veshur.Nyja e marrë në studim ndodhet në KP139-W10 nga matja e spesorit të nyjës së veshur ka rezultuar 3390 µm, vlerë e cila nuk cënon integritetin e nyjes së veshur.



Fig.3.8, Matja e spesorit te nyjës se veshur ne KP139-W10

Kontrolli i fortësisë:

Për të përcaktuar që veshja e nyjës përmbush kriteret e specifikuara në të dhënat teknike të produktit, gjithashtu për përcaktimin e kohës që veshja mund ti nënshtrohet veprimtarive mekanike, bëhen matje mbi fortësinë e veshjes dhe referuar studimit të bërë fortësia duhet të jetë e rendit 80-90 Shore D .

Nyja e marrë në studim ndodhet në KP139-W10 nga matja e fortësisë së nyjës së veshur ka rezultuar një fortësi e 85 Shore D, vlerë e cila nuk çënon integritetin e nyjes së veshur.




Fig.3.9, Matja e fortësisë se nyjes së veshur në KP120-W21

-Holiday Test:

Për të përcaktuar që struktura e metalit është 100% e mbuluar pas aplikimit dhe që nuk kemi vende të cilat ajo është e ekspozuar ndaj fenomeneve të jashtëm të cilët mund të përshpejtojnë procesin e korrozionit. Sipërfaqja e veshjes i nënshtrohet rrymave elektrike me voltazh 10-15 KV për përcaktimin e zonave të cilat mundet të

jenë të ekspozuara. Nyja e marrë në studim ndodhet në KP139-W10 nga testi i bere ka rezultuar që nyja e lyer ka pasur një defekt e cila më pas iu nënshtrua procesit të riparimit.



Fig.3.10, Kontrolli i nyjes së veshur me HD test.

Testi i adezionit:

Prova e adezionit është një provë mekanike që rezulton me dëmtimin e materialit i cili më pas duhet ti nënshtrohet një procesi riparimi.

Referuar studimit të bërë ka rezultuar që për këtë kategori produkti poliuretan kërkon një shkallë adezioni prej 3.5MPa në PE dhe 10MPa në metal në mënyrë që të mos cenohet integriteti i nyjës së veshur. Nyja e marrë në studim ndodhet në KP139-W10 nga testi i bërë ka rezultuar që nyja e lyer ka adezionin në PE 12 MPA dhe adezionin në metal 20 MPA . Ky lloj testi jep një garanci që veshja ka karakteristika adezioni të kënaqshme të cilat i plotësojnë kushtet për një periudhë operimi shumë vjeçare.



Përcaktimi i
adezionit në PE

Përcaktimi i
adezionit në metal



Adezioni në
PE 12MPa

Adezioni në
metal 20MPa

Fig.3.11, Testi i adezionit në nyjen KP139-W10

ANALIZA DCVG.

Analiza DCVG është një teknike kërkimi e cila kryhet mbi toke që përdoret për të lokalizuar defektet e jashtme të veshjes së tubit dhe të vlerësojnë madhësinë dhe orientimin e tyre në tubacionet nëntokësore pasi është kryer shtrimi dhe mbulimi i tubit. Në projektin TAP, analiza DCVG shërben për të vlerësuar integritetin e veshjes së tubacionit dhe për të identifikuar defektet e veshjes së tubacionit.

Analiza DCVG kryhet sipas kësaj radhe:

- Kryerja e analizës DCVG
- Identifikimi dhe shënimi i të gjitha vendndodhjeve , të gjitha indikacioneve DCVG
- Verifikimi në terren i të gjitha vendndodhjeve të indikacioneve DCVG
- Paraqitja e raportit DCVG me rekomandime dhe konkluzione.
- Gërmimi, inspektimi dhe riparimi i defekteve të veshjes së tubit.

Kjo analize funksionon duke aplikuar në tub një rryme të vazhdueshëm DC në forme ciklike (0.45 sek ndezur, 0.8 s fikur). Kjo gjë krijon një burim rryme pulsues DC që mund të identifikohet lehtë me anë të një voltmetri analog. Për të reaguar ndaj këtij ndryshimi kaq të shpejtë të tensionit nevojiten instrumente matës speciale.



Fig.3.11.1, Instrument matës DCVG

Gradienti i tensionit së rrymës së vazhduar matet duke vendosur në toke 2 elektroda bakër/sulfat bakri të cilat janë të lidhura me instrumentin matës DCVG. Zakonisht operatori ecën paralel me tubacionin duke i vendosur elektrodën në tokë çdo 2 metra, dhe në të njëjtën kohë duke vështuar instrumentin matës DCVG për indikacione defektesh.



Fig.3.12, Operatori i DCVG gjatë një analize DCVG në pikën kilometrike 22 të tubacionit TAP.

Në momentin kur shfaqet një defekt i veshjes së tubit, rryma e vazhduar DC do të rrjedh drejt tij duke bërë që gradienti i tensionit në tokë të ndryshojë, duke u zmadhuar kur i afrohem defektit dhe bëhet 0 në moment që epiqendra e defektit të veshjes së tubit ndodhet midis dy elektrodave.

Në momentin e gjetjes të një defekti, merren të dhënat e madhësisë së defektit, regjistrohen koordinatat GPS të defektit dhe ngulen piketa druri për të shënuar vendndodhjen e defektit.

Madhësia e defektit llogaritet si më poshtë:

$$\text{Madhësia e Defektit}(\%IR) = \frac{\text{Defekti IR(mV)}}{\text{Sinjali i aplikuar në hyrje}}$$

* Rënia IR është diferenca e potencialit elektrik midis tubit dhe tokës.

Pas identifikimit të defektit, kryhet gjurmimi dhe inspektohet nëse është defekt i veshjes së tubit apo nëse kemi të bëjmë dhe me një defekt mekanik të tubit. Nëse kemi të bëjmë dhe me një defekt mekanik të tubit, atëherë në pjesën e dëmtuar duhet të kontrollohet spessori i trashësisë së tubit me anë të Testit Ultrasonik Manual. Nëse testimi pranohet, atëherë bëhet riparimi i veshjes së tubit dhe mbulimi i tubit. % IR e të gjitha defekteve duhet të llogariten, regjistrohen dhe të maten në lidhje me madhësinë aktuale të defektit. Në projektin TAP, të gjitha vendndodhjet e defekteve DCVG janë të detyrueshme të gjurmohen dhe të riparohen²⁶.

²⁶ EN 12954:2001-Cathodic protection of buried or immersed metallic structures. General principles and application for pipelines

Rast Studimi: Analiza e defektit te gjetur me anë të teknikës DCVG.

Pas kontrollit të linjes së gazsjellsit në pikën kilometrike KP186+413 u identifikua një defekt, në një tub me trashësi nominale 24.9 mm. Pasi u zbulua ky defekt u bë vlersmi i spesorit të tij, duke e kontrolluar atë me metodën me ultratinguj dhe u arrite në konkluzionin që ky defekt nuk cënon integritetin e linjës së gazsjellësit.



Analiza DCVG, në pikën kilometrike KP186+413 ka gjetur një defekt të veshjes së tubit, u bë gërmimi dhe zbulimi i defektit.



Me pas veshja përreth defektit u hoq dhe u inspektua sipërfaqja e materialit baze. Në këtë rast kemi të bëjmë me një defekt mekanik të sipërfaqes metalike të tubit.



Pasi u bë smusimi i metalit, u mat spessori me anë të testimit ultrasonik. Pas matjes u bë vlerësimi i reduktimit të spesorit, e cila rezultojë e pranueshme. Nga studimi ka rezultuar nëse reduktimi i spesorit është më i madh së 1.5 mm nga vlera nominale, tubi duhet të zvendësohet.



Pas analizës rezultojë se rënia e spesorit ishte në vlerat e pranueshme dhe më pas vendosëm për riparimin e defektit të veshjes së tubit.

Fig.3.13, Zbulimi i nje defekti me tekniken DCVG

3.3 TESTIMI HIDROSTATIK

Procesi i testimit Hidrostatik të tubacioneve të gazit nën presion përfshin këto operacione:

- Procesin e pastrimit
- Procesin e vlerësimit të gjeometrisë së gazsjellësit
- Procesin e mbushjes me ujë
- Pre-Testet e seksioneve HDD's etj..
- Procesi i testimit ,testi i fortësisë dhe testi i rrjedhjes.
- Procesi i testimit të AGI's, BVS dhe faciliteteve të tjera
- Procesi heqjes së ujit
- Procesi final i tharjes së gazsjellësit
- Procesi i vlerësimit të ovalitetit të gazsjellësit me atë pajisjes Caliber Pig

Nga studimi i bërë është arritur në konkluzionin që të gjitha këto procese ndikojnë në integritetin e linjës së gazsjellësit, ndaj për secilin proces ne kemi ndërhyrë, duke përdorur makineri, pajisje dhe metoda të ndryshme në mënyrë që të rrisim cilësinë dhe mbronim integritetin e linjës së gazsjellësit.

Le të shpjegojmë një nga një të gjithë elementet që përmban procesi i hidrotestit dhe ndikimin e tyre në integritetin e tubacionit.

Procesi i Pastrimit

Procesi i pastrimit të tubacionit është një ndër proceset më të rëndësishme që ndikon në integritetin e linjës së gazit²⁷. Pas studimit dhe analizave të bëra rezultojë që të kemi një proces pastrim të mirë të tubacionit nga papastërtitë e mundshme që mund të jenë krijuar gjatë procesit të ndërtimit të tij duhet të kalohen tre lloje pajisjesh pastruese(Pig). Pigu i parë do të bëjë të mundur pastrimin e tubacionit nga mbetjet që mund të jenë krijuar si baltë, plastika etj , i cili do të kalohet disa herë , derisa tubi të konsiderohet i pranueshëm, dhe pigu i dytë do të jetë i pajisur me magnet që do të heqë nga tubacioni pjesët metalike që mund të jenë krijuar gjatë procesit të saldimit²⁸.

Më poshtë po e shpjegojmë se si do të realizohet ky proces:

²⁷ Jim Cordell and Hershel Vanzant, The pipeline Pigging-third edition, - Pigging during pipeline construction, cleaning.

²⁸ <https://www.offshore-mag.com/pipelines/article/16756387/graduated-pipeline-cleaning-using-enhanced-pigs>



Fig.3.14 ,Futja e pigut në kokën testuese

Pajisje të ndryshme saldoen në kokën e pastrimit me qëllim hyrjen e ajrit, nxjerrjen e ajrit, monitorimin e presionit, balancimin e presionit , kontrollin e pozicionit të pigut, hyrja dhe dalja e pigut, instalimi i valuvles së sigurisë (PSV). Kokat hyrëse dhe dalëse të pigut kane të njëjtat specifikime teknike.



Fig.3.15, Dalja e pigut

Për të arritur në pastrim sa më të mirë të tubacionit kemi përdorur pajisjen pig që lëviz në dy drejtime e përbëre nga 4 pllaka elastike që vendosen dy para, dy mbrapa dhe dy pllaka të tjera drejtuese të përbëra me material të fortë që vendosen njeri pas tjetrit.

Gjithashtu për të hequr pjesët metalike që ndodhen në tubacion e pajisjes pig ne i kemi instaluar dhe magnet.



Fig 3.16, Dalja e Pigut magnet

Gjatë procesit të pastrimit piget lëvizin me anë të ajrit. Fillimisht bëhet mbushja e linjës me ajër më pas nisët pigu, ku presioni pas tij nuk arrijn më shumë se 10 bar. Për të pasur një pastrim sa më të mirë duhet që presioni të jetë sa më i vogël dhe shpejtësia e pigut të mbahet nën kontroll. Piget do të kalojnë në tubacion deri sa të mos ketë më mbetje dhe ato që grumbullohen para pigut duhet të vinë duke u zvogëluar. Sipas specifikimeve 5 kg mbetje lejohen për volume poshtë 5000 m³ dhe 10 kg për volume më të mëdha se 5000 m³.

Pasi futet pigu në kokën pastruese fillon injektimi i ajrit para pigut në seksion jo më shumë se 4 ose 5 bar, në këtë kohë hapet dhe bajpasi për ekuivalentimin e presionit para dhe pas pigut. Më pas për të nisur pigun mbylлим bajpasin dhe fillojmë injektim e presion nga pas pigut me presion më të madhe se të injektimit.



Fig.3.17, Nisja e Pigut

Me mbërritjen e pigut në kokën pastruese fundore fillon operacioni për heqjen e ajrit dhe pasi konfirmojmë që presioni në tubacion ka arritur presionin atmosferike fillojmë operimet për të nxjerr pigun dhe bëhet inspektimi

për mbeturinat që ai ka grumbulluar dhe me pas vlerësojmë nëse tubacioni është i pastruar ose jo në bazë të kushtit të pranushmërisë²⁹.



Fig 3.18, Sasia e mbetjeve që dalin përpara pigut

Me anë të procesit të pastrimit ne vlerësojmë shkallën e pastërtisë e cila ndikon drejtpërdrejt në integritetin e tubacionit.

Vlerësim të Gjeometrisë së Gazsjellësit.

Procesi i vlerësim të gjeometrisë së gazsjellësit është një ndër proceset më të rëndësishme që ndikon në integritetin e linjës së gazit³⁰.

Pas studimit dhe analizave të bëra rezultojë që për të vlerësuar nëse tubacioni ka deformime apo jo ne e inspektojmë atë me anë të pigut duke instaluar një pllakë alumini me trashësi 10 mm. Fillimisht inspektohet pllaka e aluminit përpara se të futet në tubacion në se ka deformime apo jo, përcaktohet diametri i saj i cili nuk duhet të jetë më i madh se 98% e diametrit real të brendshëm të tubacionit minus 10 mm dhe me një spesor 10 mm.

²⁹ Bob Winters, Cleaning Pig Designs and Applications, NACE Central Area Conference.

³⁰ Jim Cordell and Hershel Vanzant, The pipeline Pigging-third edition, - Acceptance testing, Gauging.




Fig.3.19, Pllaka e Aluminit

Pasi është përcaktuar madhësia e pllakës prej alumini ajo instalohet në pig në mënyrë që të filloj nisjen në tubacion.



Fig.3.20, Gjatë instalimit dhe futjes së pigut me pllakën e aluminit në tubacion.

Pigu nisët me shpejtësi sa më të vogël duke e kontrolluar nga ajri i injektuar para tij , në mënyrë që të mos deformohet pllaka nëpër bërthmë që ka tubacioni. Vlerësimi paraprak i gjeometrisë së tubacionit bëhet përpara se të fillojë procesi i mbushjes me ujë dhe vlerësimi final kryhet gjatë shkarkimit të ujit sepse pasi tubacioni mbushet me ujë pesha e tij rritet dhe ka rrezik që ai të pësojë deformime.

Pasi pigu arrijn në fund të linjës, pllaka e aluminit i nënshtrohet kontrollit vizual për të parë nëse ka deformime apo jo në rast se ka deformime të kalohet një pig tjetër në tubacion për të parë se deformimet janë të njëjta me të pllakën e parë ose jo. Nëse deformimet janë të njëjta atëherë merren masa për të futur një pigë inteligjent në seksion për të përcaktuar ekzaktsisht vendndodhjen e defektit dhe më pas merren masa për riparimin e tij. Pigu me pllakën e aluminit do të kalojë në seksion gjatë procesit të mbushjes me ujë dhe do të kthehet përsëri mbrapa

gjatë shkarkimit të ujit do të bëhet në drejtim të kundërt me mbushjen. Pllaka e aluminit do të pranohet nëse në të nuk ka deformime, deformimet të shkaktuara nga penetrimet e saldimet janë të pranueshme³¹. Me anë të këtij procesi ne vlerësojmë gjeometrinë e tubacionit nëse ka deformime, dente, gunga etj., proces i cili ndikon drejtpërdrejt në integritetin e tubacionit.

Cilësia e Ujit

Një element tjetër i rëndësishëm që ndikon në integritet është dhe cilësia e ujit. Pas analizave dhe studimeve të realizuara u arrite ne konkluzionin që uji që do të përdoret për testim duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme :

Niveli i PH duhet të jetë ndërmjet 6 dhe 8 për ujë që do të përdoret disa herë për testimin e tubacionit ose për ujë që qëndron në tubacion për më shumë se 8 ditë. Për ujë të ndenjur me pak se 8 ditë në tubacion niveli i PH duhet të jetë ndërmjet 5 dhe 8 . Uji i detit nuk lejohet për testim, niveli i kripës nuk duhet të kalojë 800mg/l. Gjatë mbushjes së tubacionit me ujë ai duhet të filtrohet me 50 µm (micron) filtër. Pra përpara se uji të përdoret për testim atij duhet ti bëhen analizat. Uji që do të përdoret për testim duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme në mënyrë që mos të cenoje integritetin e tubacionit³².

Tabela.3.5, Karakteristikat e ujit që do të përdoren në testim

PH	6-8
BOD	25 mg/L
COD	125 mg/L
TSS*	35 mg/L or <10%
Fenole	0.5 mg/L
Sulfite	1 mg/L
Metale te renda (total)**	5 mg/l (.)
Klorite	600 /L (mesatare); 1200 mg/L (maksimum)

³¹ David Russell, Weatherford Pipeline & Specialty Services UK, Pigging in pipeline pre-commissioning.

³² Alberta Gaverment, Code of Practice for the Release of Hydrostatic Test Water from Hydrostatic Testing of Petroleum Liquid and Gas Pipelines.

4. TESTIMI HIDROSTATIK

Metodat e testimit nën presion që aplikohen për vlerësimin e integritetit në tubacionet e gazit me presion të lartë kategorizimet sipas metodës së testimit³³, si më poshtë :

- A. Metoda e inspektimit vizual
- B. Metoda e matjes së presionit
- C. Metoda e matjes precize të presionit
- D. Metoda e matjes së presionit/Volumit

Metodat e testimit sipas mjetit të testimit, si dhe presionit të aplikuar ndahen:

- 1. Me Ujë - vendosje nën presion një herë
- 2. Me Ujë – vendosje nën presion dy herë
- 3. Me Ajër
- 4. Me Gaz operues

Tabela.3.6, Metoda të testimit nën presion

Mjeti i testimit	Ujë		Ajër	Gaz operues
	një herë	dy herë		
Metoda e testimit	1	2	3	4
Metoda e inspektimit vizual	A 1	A 2	A 3	A 4
Metoda e matjes së presionit		B 2	B 3	–
Metoda e matjes precize të presionit		–	C 3	–
Metoda e matjes së presionit/volumit		D 2		–

Metoda e matjes së presionit hidrostatik - B 2.

Pas analizave të provave të ndryshme të testimit hidrostatik, metoda që kemi aplikuar për testimin e linjës kryesore të gazsjellësit është metoda B2, sipas standardit DVGW G469 të cituar më poshtë :

" Presioni i testimit në pikën më të lartë të linjës duhet të jete sa 1.3-fishi i presionit maksimal operues të lejueshëm, ndërsa në pikën më të ulët të linjës nuk duhet të tejkaloj 95 % të vlerës minimale të sforcimeve në tërheqje $R_{t0,5}$ të tubacionit.

³³ DVGW G469: 2010 – Pressure testing methods for gas transmission/gas distribution, Pressure testing method descriptions, page 12.

Gjatë vlerësimit të ndryshimit të presionit kemi marre parasysh luhatjet e temperaturës të mjetit testues, të mureve e tubit, të pjesës rrethuese të tokës dhe/ose të atmosferës rrethuese. Testimi i linjës do të fillojë vetëm pasi mjeti i testimit të ketë fituar temperaturë të njëjtë me tokën dhe ajrin e ambientit.

Gjatë testimit janë mbrojtur pjesët e ekspozuara, të pa mbuluara të tubacioneve ndaj ndikimeve të jashtme të temperaturës.

Aparatet matëse që kërkohen për matjen e presionit janë:

- Manometër kontrolli me piston (diapazoni i matjes afërsisht 1.5-fish i presionit të testimit)
- Aparat për matjen e presionit me një saktësi matjeje minimalisht 0,1 % (p.sh. manometër me piston)
- Aparat regjistruues presioni Klase 1,0 (diapazoni i matjes afërsisht 1,5-fish i presionit të testimit)
- Manometër (Filling gauge) Klase 1,0 (diapazoni i matjes afërsisht 1,5-fish i presionit të testimit).

Të gjitha ndryshimet e presionit që ndodhin gjatë periudhës së testimit janë regjistruar me ndihmën e një regjistruesi të matjes së presionit.

Aparatet matëse që kërkohen për matjen e temperaturave janë:

- Termometër për ajrin jashtë
- Termometër për murin e tubit të zonave të mbuluara dhe të hapura të tubacionit me thellësi futje të mjaftueshme deri në pikën e sipërme të tubacionit.
- Termometër për të matur temperaturën e ujit në tub.

Për matjen e temperaturave në murin e tubit vendoset një termometër për çdo 2,5 km të gjatësisë testuese, minimalisht duhet të vendosen tre.

Metoda e aplikimit të metodës B2.

Mbas mbushjes dhe largimit të ajrit presioni i testimit aplikohet me një rritje presioni deri në maksimalisht 3 bar/min. Para testimit kontrollohet mungesa e ajrit. Mbas një kohe prej 60 minuta presioni i testimit duhet të shkarkohet aq sa në pikën më të lartë të tubacionit të kemi arritur një presion minimal prej 2 bar. Koha e mbajtjes së këtij presionit të reduktuar të testimit është 30 minuta. Pas kësaj rritet përsëri presioni në nivelin e presionit të testimit dhe mbahet nën presion për 24 orë. Gjatë kësaj kohe regjistrohen vlerat e matjeve të presionit dhe lexohen temperaturat e murit të tubit " ³⁴.

³⁴ DVGW G469: 2010 – Pressure testing methods for gas transmission/gas distribution, Hydrostatic pressure measurement B 2, page 13-14.

Llogaritjet analitike do të kryhen sipas standartit DVGW G469 të cituar më poshtë :

"Sasia faktike e ujit të shkarkuar krahasohet me sasinë e përlllogaritur të shkarkimit mbi bazën e formulës matematike të mëposhtme:

$$\Delta V_A = \frac{\left(0,89 \frac{r_i}{s} + A\right) \cdot V_{ri} \cdot (p_1 - p_2)}{1000} \quad (1)$$

Kur kemi trashësi muri dhe reze tubi të ndryshme duhet që për herësin r_i/s të gjendet vlera përkatëse korresponduese e volumeve dhe e trashësisë së mureve si më poshtë:

$$\frac{r_i}{s} = \frac{r_{ix}}{s_x} \times \frac{V_x}{V_{ges}} + \frac{r_{iy}}{s_y} \times \frac{V_y}{V_{ges}} \quad (2)$$

Midis sasisë së ujit të shkarkuar të përlllogaritur dhe ujit të shkarkuar faktikisht mund të ketë diferenca të ndryshme, të cilat mund të shkaktohen nga bllokimet e ajrit, ovalitetet e tubacionit, tolerancat e trashësisë së murit dhe të diametrit. Duke marrë parasysh gjithmonë një saktësi të mjaftueshme për vlerësimin e matjeve këto diferenca nuk duhet të jenë më tepër se 6 %, ku gjithsesi devijimet duhet të merren parasysh nga raporti:

$\Delta V_{Ab}/\Delta V_A$. Nëse nuk ka devijime, raporti $\Delta V_{Ab}/\Delta V_A = 1,0$. Ndryshimi i volumeve të segmenteve të tubacioneve që do të testohen mund të gjendet me ndihmën e këtij ekuacioni të gjendjes:

$$\Delta V = \left(0,89 \frac{r_i}{s} + A\right) \cdot \frac{\Delta V_{AB}}{\Delta V_A} \cdot (p_1 - p_2) - B(T_1 - T_2) \cdot \frac{V_{ri}}{1000} \quad (3)$$

Në rast se kemi trashësi muri të ndryshme dhe rreze tubi të ndryshme, formula (2) do të përdoret respektivisht në formulën (3).

Ku:

ΔV	ndryshimi i volumit në (l)
ΔV_h	ndryshimi i volumit për orë në (l/h) (litra/orë)
ΔV_A	sasia e përlllogaritur e shkarkimit në (l)
ΔV_{AB}	sasia faktike e shkarkimit në (l)
V_{ri}	volumi i segmentit të testimit me një rreze tubi r_i në (m ³)

r_i	rrezja e brendshme e tubit në (mm)
s	trashësia e murit ekzistues në (mm)
A	koefiçienti i kalkulimit sipas Shtojcës A në (1/bar)
B	koefiçienti i kalkulimit sipas Shtojcës A në (1/K)
p	presioni statik në tubacionin në (bar)
T	temperatura mesatare e ponderuar e linjës së tubacioneve në (K)
l	gjatësia e tubacionit në (m)
Indeks 1	në fillim të testimit.
Indeks 2	në përfundim të testimit.
Indeks x, y,	segmentet totale dhe/ose trashësitë.

- 0,89- koefiçienti i përlllogaritjes për ndryshimin e volumeve të shkaktuar nga ndryshimi i presionit në tubacionet e çelikut nën tokë në 10^{-6} bar⁻¹. Ky koefiçient përlllogaritje aplikohet për tubat e çelikut me modul elasticiteti Young: $E = 206\,000$ në N/mm² dhe një koefiçient i Poisson $\mu = 0,3$ [-] [$= 2 \times 10^5 \times ((1 - \mu^2)/E)$]

Për shkak të tolerancës në matje të kësaj metode lindin edhe ndryshime në volume, të cilat në shumën e tyre të përgjithshme nuk kompensojnë njëra-tjetrën dhe nëpërmjet vendosjes së të gjitha tolerancave mund të konvertohen në formulat përkatëse të përlllogaritjes. Prandaj dhe për përcaktimin e ndryshimit të volumeve të lejueshme për orë është e mjaftueshme përdorimi i një formule të thjeshtuar, si më poshtë:

$$\Delta V_h \leq \pm 4 \cdot \frac{V_{ri}}{3000}, \text{ në l/h} \quad (4)$$

Ku aplikohen vlerat limit të mëposhtme:

- a) për diametrat e jashtëm të tubacioneve $d_a \geq 500$ mm, në rastet kur gjatë presionit të testimit në të gjitha tubat aplikohet një sforcim periferik, i cili është minimalisht sa 87 % e kufirit minimal të sforcimit në tërheqje $R_{t\,0,5}$, në varësi të trashësisë minimale të murit: $0,3 \text{ l/h} \leq \Delta V_h \leq 4,0 \text{ l/h}$
- b) për diametrat e jashtme të tubacioneve $d_a \geq 500$ mm, në rastet kur gjatë presionit të testimit jo në të gjitha tubat aplikohet një sforcim periferik, i cili është minimalisht sa 87 % e kufirit minimal të sforcimit në tërheqje $R_{t\,0,5}$, në varësi të trashësisë minimale të murit, si dhe për diametrat e tubacioneve $d_a < 500$ mm: $0,05 \text{ l/h} \leq \Delta V_h \leq 0,8 \text{ l/h}$ " ³⁵.

³⁵ DVGW G469: 2010 – Pressure testing methods for gas transmission/gas distribution, Calculation, page 15-16.

Llogaritjet analitike të cituar me sipër të marra nga standardi DVGW G469 janë të domosdoshme për realizimin e testimit të linjave kryesore të gazsjellësit, me ane të të cilave më poshtë kemi nxjerre relacionet e ndryshimit të presionit në funksion të ndryshimit të volumit dhe temperaturës.

Përcaktimi i korrelacionit të ndryshimit të presionit në funksion të ndryshimit të temperaturës dhe volumit.

Mënyra e 1^{-rë}

Ndryshimi i volumeve të segmenteve të tubacioneve që do të testohen mund të gjendet me ndihmën e këtij ekuacioni të gjendjes.

$$\Delta V = \left[\left(0.89 \times \frac{r_i}{s} + A \right) \times \frac{\Delta V_{AB}}{\Delta V_A} \times (P_1 - P_2) - B \times (T_1 - T_2) \right] \frac{V_{ri}}{1000} \quad (\text{Referuar standartit DVGW G469})$$

Nëse nuk ka devijime:

atëherë raporti $\Delta V_{Ab}/\Delta V_A = 1,0$.

$$\Delta V = \left[\left(0.89 \times \frac{r_i}{s} + A \right) \times \Delta P - B \times \Delta T \right] \frac{V_{ri}}{1000} \quad (5)$$

$$\frac{1000 \times \Delta V}{V_{ri}} = \left(0.89 \times \frac{r_i}{s} + A \right) \times \Delta P - B \times \Delta T$$

Per $\Delta V = 0$ kemi :

$$\left(0.89 \times \frac{r_i}{s} + A \right) \times \Delta P - B \times \Delta T = 0$$

$$\frac{\Delta P}{\Delta T} = \frac{B}{\left(0.89 \times \frac{r_i}{s} + A \right)} \quad (6)$$

Per $\Delta T = 0$ kemi :

$$\frac{\Delta P}{\Delta V} = \frac{1000}{\left(0.89 \times \frac{r_i}{s} + A \right) \times V_{ri}} \quad (7)$$

"Ku vlerat e koeficientave A dhe B përlllogariten nga derivatet pjesore të volumeve specifike sipas:

$$A = \frac{-10^6 \left(\frac{\partial v}{\partial p} \right)_T}{v} ; \quad B = \frac{10^6 \left(\frac{\partial v}{\partial p} \right)_P}{v - 28,86 K^{-1}} \quad (8)$$

Koefiçienti 28,86 aplikohet për tubat e çelikut (të shtrira nën tokë) me koefiçientin e Poisson $\mu = 0,3$ [-] dhe me një koefiçient linear të sforcimit në tërheqje prej $\beta = 11,1 \times 10^{-6}$ 1/K . Për tubacionet e materialeve të tjera kalkulohet si më poshtë: $\Delta B = 2 \times 10^6 \beta (1 + \mu)$. Për tabelat janë llogaritur volumet specifike të ujit dhe derivatet e tij pjesore; rrjedhimisht A dhe B janë llogaritur duke përdorur formulat matematikore të përmendura në standardin industrial IAPWS-IF 97³⁶.

Vlerat e koefiçientave A dhe B varen pothuajse në mënyrë lineare nga presioni. Vlerat e presioneve të ndërmjetme të vlerave në tabelë mund të përcaktohen me interpolim. Në Aneksin 1 do të gjeni vlerat e koefiçienteve A dhe B³⁷.

Mënyra e 2-të

Korrelacioni ndërmjet ndryshimit të presionit në funksionit të volumit dhe temperaturës sipas si më poshtë:

$$\frac{\Delta V}{V_0} = \left[\frac{1 - \mu^2}{E} \times \frac{D}{t} + A \right] \Delta p - B \Delta T \quad (\text{Referuar standartit AS/NZS 2885.5}^{38}) \quad (9)$$

$$\frac{\Delta V}{V_0} = \left[\frac{1 - \mu^2}{E} \times \frac{D}{L} \left(\frac{L_1}{t_1} + \frac{L_2}{t_2} + \dots \right) + A \right] \Delta p - B \Delta T$$

$$\Delta V = \left[\frac{1 - \mu^2}{E} \left(\frac{V^1 D^1}{t_1} + \frac{V^2 D^2}{t_2} + \dots \right) + A V_0 \right] \Delta p - B V_0 \Delta T$$

$$\frac{\Delta V}{V_0} = \left[\frac{5 - 4\mu}{4E} \times \frac{D}{t} + A \right] \Delta p - \bar{B} \Delta T$$

$$\frac{\Delta V}{V_0} = \left[\frac{5 - 4\mu}{4E} \times \frac{D}{L} \left(\frac{L_1}{t_1} + \frac{L_2}{t_2} + \dots \right) + A \right] \Delta p - \bar{B} \Delta T$$

$$\Delta V = \left[\frac{5 - 4\mu}{4E} \left(\frac{V^1 D^1}{t_1} + \frac{V^2 D^2}{t_2} + \dots \right) + A V_0 \right] \Delta p - \bar{B} V_0 \Delta T$$

Për $\Delta V = 0$ kemi :

³⁶ IAPWS-IF 97 Internacional Association for the Properties of Water and Steam.

³⁷ DVGW G469: 2010 – Pressure testing methods for gas transmission/gas distribution, Annex A (normative) – Calculation values A and B, page 23.

³⁸ AS / NZS 2885.5:2012 Pipelines - Gas and Liquid Petroleum - Field Pressure Testing.

$$\frac{\Delta P}{\Delta T} = \frac{\bar{B}V_0}{\left[\frac{5-4\mu}{4E} \left(\frac{V_1^2 D^4}{t_1} + \frac{V_2^2 D^4}{t_2} + \dots \right) + AV_0 \right]} \quad (10)$$

Për $\Delta T = 0$ kemi :

$$\frac{\Delta P}{\Delta V} = \frac{1}{\left[\frac{5-4\mu}{4E} \left(\frac{V_1^2 D^4}{t_1} + \frac{V_2^2 D^4}{t_2} + \dots \right) + AV_0 \right]} \quad (11)$$

Ku A ,B dhe $\bar{B}$ për ujin që përdoret për testim janë :

$$A = (3.897 \times 10^{-3} \times T^2 - 0.3133 \times T + 50.65) \times (1 - p/411844) \times 10^{-8}, \quad (\text{AS/NZS 2885.5}) \quad (12)$$

$$B = \left[(3.102 - 0.07983 \times T) \times \frac{p}{1000} + \sqrt{14872 \times T + 175490} - 483.3 \right] \times 10^{-6}, \quad (\text{AS/NZS 2885.5}) \quad (13)$$

$$\bar{B} = B - 4.68 \times 10^{-6} \quad (14)$$

ΔV =Ndryshimi i volumit në seksion në litra

V_0 =Volumi i përgjithshëm i seksionit

V_1, V_2, etc = Volumi i çdo elementi të seksionit ,për gjatësi diameter dhe spensor te ndryshëm.

D = Diametri i jashtëm i tubacionit ,mm

t =Spensori i tubacionit në se ai është uniform.

$t_1, t_2 \text{etc}$ =Spensor të ndryshëm të tubacionit.

L =Gjatësia e tubacionit në se është uniforme

$L_1, L_2 \text{etc}$ =Gjatesi të ndryshme të tubacionit

Δp =Ndryshimi i presionit, Kpa

P =Presioni i çdo komponenti në KPa.

ΔT =Ndryshimi i Temperaturës ,°C

T =Temperatura

A = Koeficienti ngjeshjes së ujit që do të përdoret për testim(kPa-1)

B = Koefiçenti i temperaturës së zgjerimit të çelikut për mjetin e testimit
degrees Celsius (°C-1) ,kur tubi është i kufizuar

$\bar{B}$ = Koeficienti i temperaturës së zgjerimit të çelikut për mjetin e testimit
degrees Celsius (°C-1) ,kur tubi është i pakufizuar.

β = Koefiçenti termik i zgjerimit të volumit të mjetit të testimit, °C-1

Mënyra e 3^{të}

Korrelacioni ndërmjet ndryshimit të presionit në funksionit të volumit dhe temperaturës sipas si më poshtë:

$$\frac{\Delta V}{V} = \left[2 \frac{1 - \nu^2}{E} \frac{r}{s} + A \right] \Delta P - [\beta - 2\alpha(1 + \nu)] \Delta T \quad (\text{Referuar Total Company Specifications}). \quad (15)$$
$$\frac{\Delta V}{V} = \left[\frac{5 - 4\nu}{2E} \frac{r}{s} + A \right] \Delta P - [\beta - 3\alpha] \Delta T$$

Ku :

s = Spesori

r = Rrezja e tubacionit

V = Volumi i seksionit

ΔV = Volumi i llogaritur

ΔP = Rënia e presionit gjatë testimit

ν = Koeficienti i Puasonit

E = Moduli i elasticitetit

β = Koeficienti termik i zgjerimit të volumit të mjetit të testimit,

α = Koeficienti termik i zgjerimit për materialin e tubit.

ΔT = Ndryshimi i temperaturës gjatë testimit

A = $1/K$, ku K-Bulk faktor për mjetin e testimit uje.

Per $\Delta V = 0$ kemi :

$$\frac{\Delta P}{\Delta T} = \frac{[\beta - 2\alpha(1 + \nu)]}{\left[2 \frac{1 - \nu^2}{E} \frac{r}{s} + A \right]} \quad (16)$$

$$\frac{\Delta P}{\Delta V} = V \times \left[2 \frac{1 - \nu^2}{E} \frac{r}{s} + A \right] \quad (17)$$

A = $1/K$

B = $\times -2\alpha(1 + \nu)$

B = $\times -3\alpha$

t = temperature($^{\circ}\text{C}$)

S = kripësi(‰)

P = presioni(bar)

β = koeficienti volumetrik

Moduli Bulk K(bar)

$$K = K^0 + AP + BP^2$$

P = Presioni

$$\begin{aligned} K^0 = & 19654.32 + 147.037 t - 2.21554 t^2 + 1.0478 \times 10^{-2} t^3 - 2.2789 \times 10^{-5} t^4 \\ & + (51.2614 - 0.45222 t + 2.6834 \times 10^{-3} t^2) S(\%) \\ & + (0.66286 + 7.281 \times 10^{-3} t) S(\%)^{3/2} \end{aligned} \quad (18)$$

$$\begin{aligned} A = & 3.2891 - 2.3910 \times 10^{-3} t + 2.8446 \times 10^{-4} t^2 - 2.82 \times 10^{-6} t^3 + 8.477 \times 10^{-9} t^4 \\ & + (4.9305 \times 10^{-3} - 1.74067 \times 10^{-4} t + 3.7712 \times 10^{-6} t^2) S(\%) \\ & + (-2.932 \times 10^{-4}) S(\%)^{3/2} \end{aligned} \quad (19)$$

$$\begin{aligned} B = & 6.2450 \times 10^{-5} - 3.913 \times 10^{-6} t - 3.499 \times 10^{-8} t^2 + 7.942 \times 10^{-10} t^3 \\ & - 3.299 \times 10^{-12} t^4 + (-1.17249 \times 10^{-6} + 1.40136 \times 10^{-7} t - 2.26045 \times 10^{-9} t^2) S(\%) \end{aligned} \quad (20)$$

$$\beta = \beta_e + A S(\%) + B S(\%)^{3/2}$$

$$\begin{aligned} \beta_e = & -6.80977 \times 10^{-5} + 1.82945 \times 10^{-5} t - 3.2519 \times 10^{-7} t^2 + 6.4062 \times 10^{-9} t^3 \\ & - 8.8997 \times 10^{-11} t^4 + 5.846 \times 10^{-13} t^5 + (3.7409 \times 10^{-7} - 1.5881 \times 10^{-8} t \\ & + 2.9713 \times 10^{-10} t^2 - 3.5431 \times 10^{-12} t^3 + 1.741 \times 10^{-14} t^4) P + (-9.6658 \times 10^{-11} \\ & + 4.8741 \times 10^{-12} t - 1.0169 \times 10^{-13} t^2 + 9.941 \times 10^{-16} t^3) P^2 + 4.75 \times 10^{-16} P^3 \end{aligned} \quad (21)$$

$$\begin{aligned} A = & 4.04385 \times 10^{-6} - 1.399 \times 10^{-7} t + 1.727 \times 10^{-9} t^2 - 1.944 \times 10^{-11} t^3 \\ & + (-3.219 \times 10^{-9} + 1.0353 \times 10^{-10} t - 8.365 \times 10^{-13} t^2) P \\ & + (7.183 \times 10^{-13} - 1.636 \times 10^{-14} t) P^2 \end{aligned} \quad (22)$$

$$\begin{aligned} B = & -1.058 \times 10^{-7} + 1.308 \times 10^{-9} t + 2.125 \times 10^{-11} t^2 + 1.69 \times 10^{-12} t^3 \\ & + (8.446 \times 10^{-11} - 1.88 \times 10^{-12} t) P \quad (\text{Referuar Total Company specification}). \end{aligned} \quad (23)$$

Llogaritjet e mësipërme i kemi programuar dhe në çdo kohë marrim raportin e ndryshimit të $\frac{\Delta P}{\Delta T}$ dhe të $\frac{\Delta P}{\Delta V}$ për çdo proces testimi, të cilën do ta shohim në testimin e linjave kryesore të gazsjellësit.

Procesi i Tharjes së Tubacionit

Një element i rëndësishëm që ndikon në integritetin e tubacionit është dhe procesi i tharjes. Referuar analizave dhe studimit të realizuar rezulton se tubacioni konsiderohet i thare nëse aplikohen metodat e mëposhtme:

- 1.Përdorimi i pigut sfungjer me anë të cilit hiqet sasia e madhe e ujit , pigu do të kalojë në tubacion deri sa penetrimi i ujit në sfungjerë të jetë më i vogël se 2 mm.
- 2.Përdorimi i pajisjes për tharjen e tubit me ajër, me anë të cilës do të injektojmë ajër të thatë në seksion deri sa pika e vesës të jetë më e vogël se -20°C .³⁹

Pigu Inteligjent:Caliper

Përveç kalimit të pigut me pllakën metalike në linjën e gazsjellësit, ne vendosëm që të kalojmë edhe pigun inteligjent , i cili do të bëjë të mundur identifikimin dhe të përcaktojë vendndodhjen e defekteve të ndryshme që mund të ketë si dente ,gunga ,ovalitete, gjithashtu mund të përcaktojë dhe identifikojë vendet ku ka rënie spessori etj..




Fig.3.21, Caliper Pig

Me anë të Caliper Pig ne mund të marrim dhe pamje në 3D të tubacionit për deformimet që ai mund të ketë⁴⁰.

³⁹ Evaluation of pipeline -drying techniques, Andrew Barden, Marvin D Powers and Philip Karaklis.

⁴⁰ EN12327:2000 - Gas supply systems - Pressure testing, commissioning and decommissioning procedures.





Fig.3.22, Deformimet e tubit të konstatuara nga caliper pig

KREU IV

Rast studimi :Aplikimi i procesit të pastrimit, vlerësimit të gjeometrisë dhe tharjes në seksionin nr.1, të gazsjellësit tap-shqipëri.

4.1 Vlerësimi i pastërtisë së seksionit KP209 deri në KP197

Seksioni që do të nënshtrohet procesit të vlerësimit ka këto të dhëna:

Tabela.4.1, Të dhënat për seksionin

SEKSIONI NR.1 I GAZSJELLSIT TAP	
Diametri i jashtëm	48" / 1219.2mm
Gjatësia e seksionit	11 477m
Volumi i seksionit	12550 m ³
Spesori	17.5mm, 21mm, 24,9mm
